



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në
“Agjencinë e Prokurimit Publik”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“Auditim Përputhshmërie”

Dhjetor 2017

Përmbajtja:

Drejtimit e auditimit	Faqe
1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.	8-8
2. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të APP-së. - Zbatimi i kritereve dhe procedurave të hartimit të planit të buxhetit. - Zbatimi i buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar. - Zbatimi i kritereve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit me destinacion fondet e investimeve, argumentimi i kërkesave për transferimet dhe ndryshimet për shtesa e pakësim të fondeve për investime.	8-12
3. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. - Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportimit, respektimi i afateve; - Mbajtja dhe plotësimi i dokumentacionit financiar kontabël; - Zbatimi i ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të kryera përmes arkës, bankës në lekë dhe veprimet në valutë për periudhën objekt auditimi; - Inventarizimi i pronës shtetërore.	12-19
4. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.	19-23
5. Mbi përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;	23-29
6. Mbi verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës: - Verifikime të kryera gjatë periudhës objekt auditimi, kriteret e përdorura në përzgjedhjen e tyre; - Rezultatet nga verifikimet, vendosja e gjobave ose propozimi për marrjen e masave administrative si dhe përputhja e tyre me shkeljet e dispozitave ligjore dhe nënligjore;	29-44
7. Mbi sigurimin e transparencës, bashkëpunimit me të tretët, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik; me entet e tjera për zbatimin e standardeve kombëtare në përgatitjen e specifikimeve teknike nga autoritet kontraktore; me organet e auditimit publik, si KLSH, strukturat e Auditimit të Brendshëm, Inspektimin Financiar mbi shqyrtimin e raporteve audituese të paraqitura prej tyre.	44-51

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Për realizimin e këtij Projekt auditimi, nga grupi i auditimit është vepruar në përputhje me standardet e auditimit, ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, rregulloret dhe Kodin Etik të KLSH-së. Grupi i auditimit ka vlerësuar veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe aktivitetin e përgjithshëm të institucionit, me qëllim që të japë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur mbi zbatueshmërinë e ligjeve e akteve nënligjore. Nga KLSH në zbatim të drejtimeve të auditimit është vlerësuar përputhshmëria me ligjet mbi planifikimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit të APP-së, mbi hartimin e pasqyrave financiare, kryerjen e shpenzimeve, inventarizimin e pronës si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, ku ka rezultuar se në përgjithësi informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit përveç disa rasteve të trajtuara hollësisht në RPA, është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit.

Një vend të rëndësishëm në këtë auditim ka veprimtaria e APP-së në përputhje me ligjin, lidhur me shqyrtimin e kërkesave për mendim dhe interpretim nga autoritet kontraktore, operatorët ekonomikë apo palë të treta, propozimet për përmirësime në legjislacion, monitorimin e procedurave të prokurimit të kryera nga vetë institucioni, mbas fazës së lidhjes së kontratës, shqyrtimin e raporteve të auditimit të KLSH-së, auditimeve të brendshme, konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, pasi produkti “vendimmarrjet” e saj kanë ndikim në gjithë procesin e prokurimit publik, si dhe në një gamë të gjerë të strukturave apo grupeve të interes që veprojnë në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve, apo ankandeve publike. Për këtë arsye në mënyrë të përmbledhur paraqesim më poshtë gjetjet dhe rekomandimet kryesore të këtij auditimi:

▪ *Mbi kriteret e monitorimit:*

- Për periudhën e auditimit, është evidentuar se AK kanë realizuar një numër të konsiderueshëm procedurash “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, të cilat në raport me procedurën “tender i hapur” në vitin 2015 rezultojnë të jenë 1.8 herë më shumë, në vitin 1.2 herë më shumë dhe në janar-gusht 2017 rezultojnë 1.5 herë më shumë. Gjithashtu, APP gjatë periudhës objekt auditimi, nuk ka kryer asnjë hetim administrativ (monitorim), për “Marrëveshjet kuadër” “Koncesionet/PPP” dhe “Ankandet publike”.

Rekomandimi: Për të përmirësuar treguesit e monitorimit duhet të merren masa për një organizim më të mirë dhe më gjithëpërfshirës të planit të monitorimeve, me qëllim kryerjen e monitorimeve për të gjitha llojet e procedurave në proporcion me numrin, rëndësinë, fondet, riskun që paraqesin, në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve/PPP dhe ankandeve publike.

▪ *Mbi kryerjen e monitorimeve:*

- APP në vendimet e saj, ka argumentuar se pavarësisht shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore, nuk kanë rezultuar pasoja dhe bazuar në këtë fakt janë dhënë masat ndaj autoriteteve kontraktore. Konkretisht për shkelje të nenit 53 pika 3 të LPP-së, ku AK kanë kualifikuar operatorë ekonomike të cilët nuk kanë plotësuar kriteret kualifikuese, mbahen qëndrime të ndryshme, duke ju referuar kriterëve të paplotësuar nga operatorët ekonomikë, gjë që vjen në kundërshtim me ligjin “Për prokurimin publik”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, DST ku mosplotësimi i një kriteri kualifikues është i mjaftueshëm për s’kualifikimin OE nga gara, nuk përcaktohet që një kriter kualifikues prevalon mbi tjetrin. Për rrjedhojë gjykimi i specialistëve të APP-së mbi rëndësinë e kriterëve nuk ka mbështetje ligjore.

- Përcaktimi i masave administrative dhe disiplinore nga APP, nuk është bërë në përputhje me shkeljet e konstatuara dhe vlerën limit të kontratës. Përsa i përket argumentimit të pasojave që

këto shkelje kanë sjellë në procedurat e prokurimit të hetuara nga APP, kjo e fundit në të gjitha rastet është shprehur se: “shkeljet e evidentuara nuk kanë sjellë pasoja”, për rrjedhojë kriteri mbi të cilin duhej të zbatohet masa administrative është vlera limit e kontratës. Nga auditimi ka rezultuar se në dhënien e masave administrative nuk është zbatuar asnjë kriter i cili të jetë relatuar gjatë shqyrtimit të praktikës apo në dispozitivin e vendimit të APP-së, në asnjë procedurë ligjore apo rregullore/udhëzues të përcaktuar nga vetë APP.

- Në trajtimin dhe evidentimin e shkeljeve të autoriteteve kontraktore, në të gjitha rastet e mësipërme nga ana e specialistëve të monitorimit, gjatë trajtimit të tyre dhe nxjerrjes së përgjegjësisë është aplikuar rëndom “Tërheqje vëmendje” apo “Këshillim”. Së pari, në ligj nuk parashikohet “Tërheqja e vëmendjes” apo “Këshillimi” si masë, pas përfundimit të hetimit administrativ. Për më tepër APP, ka të drejtën e ushtrimit të këshillimit në zbatim të LPP-së, neni 13, pika 2/d ku përcaktohet: “Në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi”.

Së dyti, këshillimet dhe tërheqja e vëmendjes, nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë konkluzioni përgjithësues dhe që t’i shërbejë në të ardhmen AK, por janë tërheqje vëmendje dhe këshillime ndaj AK, në raste kur nuk janë zbatuar nene të ndryshme të ligjit apo akteve rregullore, për të cilat në disa raste ligji parashikon penalitet përkatës apo dhënie të masave disiplinore.

Rekomandimi: Titullari i APP-së të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e rregullores së procedurave (manual/udhëzim) mbi të cilin duhet të mbështeten specialistët e APP-së gjatë kryerjes së hetimit administrativ (monitorimit), ku të përcaktohet:

-Shkalla hierarkike e zhvillimit të procedurës që nga nxjerrja urdhrit deri tek vendimi, personat që do të përfshihen në monitorimin e një praktike si dhe përgjegjësitë e tyre referuar trajtimit të çështjes dhe vendimmarrjes;

-Të përcaktohet shkalla e masës administrative në raport me vlerën limit të kontratës, duke u mbështetur edhe në aktet tjera ligjore që rregullojnë këtë procedurë;

-Të përcaktohet shkalla e shkeljeve sipas rëndësisë së tyre, cilat do të konsiderohen shkelje që sjellin pasoja dhe cilat janë shkelje që nuk sjellin pasoja;

-Të përcaktohen se cila prej masave që parashikon ligji për t’u aplikuar është më ndëshkuese, masa administrative apo masa disiplinore;

- Të përcaktohet formati dhe rubrikat apo kapitujt që duhet të përmbajë vendimi i monitorimit;

- Të përcaktohet paraprakisht hartimi i një projektvendimi, ku të paraqiten propozimet e specialistëve mbi masat ndaj AK, i cili me miratim me/ose pa vërejtje nga ana e titullarit të kalohet në vendim.

- Të parashikohet mënyra e trajtimit të rasteve kur mangësitë e konstatuara nuk përbëjnë rast për dhënie mase. Rekomandojmë që për këto raste të dilet me konkluzione dhe rekomandime, të cilat nëse janë përgjithësuese të publikohen në faqen e APP-së dhe t’ju shërbejnë të gjithë AK.

▪ *Mbi transparencën dhe bashkëpunimin:*

Një mangësi e konstatuar, është se APP nuk publikon në faqen e internetit arsyetimet dhe vendimet, në kuadrin e shqyrtimit të raporteve të institucioneve audituese, apo hetimit administrativ që kryen vetë institucioni, dhënien e masave administrative, gjoha sipas nenit 72/1 të LPP, propozime për titullarët e AK-ve për masa disiplinore, si dhe vendimet për përjashtimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Rekomandimi: Në programet e transparencës të bëhen plotësime duke përfshirë në të edhe publikimin e materialit të plotë të vendimeve të APP për masat administrative e disiplinore ndaj personave përgjegjës, të argumenteve që paraqiten lidhur me përjashtimin e operatorëve ekonomikë, përkohësisht nga procedurat e prokurimit. Kjo i shërben mirëqeverisjes së

institucionit, transparencës, duke zgjeruar lirinë e aksesit në dokumentacionin administrative, lirinë e informacionit, garancinë e një drejtësie administrative dhe motivimin e vendimeve të marra. Gjithashtu, kjo i shërben përgjegjshmërisë, që nënkupton përgjegjësinë e vendimmarrësve, kontrollet mbi administratën, etj.

▪ *Mbi efektin dhe zbatimin e penaliteteve të vendosura nga APP:*

Nga auditimi ka rezultuar se APP nuk administron asnjë të dhënë mbi zbatimin e penaliteteve dhe masave disiplinore nga AK. Për këtë arsye APP nuk mund të vlerësojë nivelin e zbatueshmërisë së tyre, apo efektet e këtyre masave apo gjobave të vendosura.

Rekomandimi (përmirësim ligjor): Autoritetet Kontraktore brenda 30 ditëve të dërgojë në APP informacion mbi masat e marra për vendosjen e gjobave dhe masave disiplinore të ndërmarra nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, sipas propozimeve të APP-së, për personat përgjegjës.

Në përfundim të këtij auditimi nga KLSH janë dhënë disa rekomandime për përmirësime ligjore, si të LPP-së, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të disa udhëzimeve të dala në zbatim të tyre, të cilat janë trajtuar në Kapitullin IV “Gjetjet dhe rekomandimet” Seksioni “Rekomandimet për përmirësime”, faqe 53-65.

II. HYRJA:

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 860/2 datë 13.09.2017, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.09.2017 deri në datë 17.11.2017, në subjektin Agjencia e Prokurimit Publik, për periudhën nga 01.01.2015 deri ne 31.08.2017 (Për shqyrtimin e një çështje që lidhet me ankesën për përjashtim të operatorit ekonomik “Colombo” shpk, ky afat është deri më 31.10.2017), u krye auditimi “Mbi vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Fadil Dekovi, Përgjegjës Grupi
2. Brunilda Zeneli, Audituese
3. Erjola Meçaj, Audituese

Titulli. Auditim përputhshmërisë në Agjencinë e Prokurimit Publik, lidhur me transaksionet financiare, zbatimi i legjislacionit të prokurimit në procedurat e vendimmarrjes lidhur me shqyrtimin e rekomandimeve të organeve audituese për procedurat e prokurimit, hetimin administrativ dhe përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga procedurat e prokurimit, për një afat nga 1-3 vjet etj.

Marrësi: Raporti Përfundimtar i Auditimit merret nga Agjencia e Prokurimit Publik, me të cilin njihen të gjithë zyrtarët e institucionit.

Objektivat dhe qëllimi: Auditimi është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe aktivitetit të përgjithshëm të Agjencisë të Prokurimit Publik, dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Zbulimi i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë, eficientë, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar me qëllim që për

rastet individuale të identifikuara të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve, dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

Identifikimi i çështjes: Auditim i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të transaksioneve e vendimeve që janë marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, sidomos në fushën e shqyrtimit të rekomandimeve të organeve audituese, të procedurave të hetimit administrativ dhe të vendimmarrjes për përjashtimin e operatorëve ekonomik nga prokurimet publike.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit)

Bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar; ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandet publike” i ndryshuar, si dhe Rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit, grupi i auditimit u ndal në detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të APP si sektori juridik, i monitorimit etj.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzione dhe opinionin për çështjet në auditim. Auditimi është kryer me zgjedhje, ku për kryerjen e tij grupi i auditimit është mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga subjekti i audituar, evidencat e ndryshme në format të printuar dhe elektronik, si dhe në ballafaqimin e problemeve nëpërmjet kontakteve verbale e shkresore me subjektin e audituar. Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar duke përfshirë testimet, komunikimin e vazhdueshëm me stafin dhe specialistët e subjektit objekt auditimi, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë për zbatimin e përputhshmërisë se në çfarë masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara.

Kriteret e vlerësimit:

Vërtetësia e përputhshmërisë se në çfarë masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
- procedurat e mekanizmave të auditimit, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
- nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
- anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
- ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe;
- shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve;
- vlerësimin me objektivitet, profesionalizim dhe paanshmëri i observacioneve të paraqitura nga subjekti i audituar.

Për të arritur objektivin, u bazuam në:

- Ligjin organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandet publike”
- Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” me ndryshime;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” me ndryshime.
- Rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015;
- Rregulloren “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së;
- Rregulloren e Brendshme e APP-së.
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”
- VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat (PPP)”;
- VKM nr. 130, datë 13.03.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit PPP”;
- VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, etj.

Standardet e auditimit: Standartet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës, janë në përputhje ligjin nr. 154/2014, “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 3, pika 5, me Kodin Etik dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, sipas përcaktimit të ISSAI 100, “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në çfarë mase subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.”, duke përdorur gjykimin profesional specifikisht në ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në praktikat më të mira të fushës” si dhe manualin e përputhshmërisë botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i përgjithshëm:

Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik e privat” dhe Ligjin Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik fokusohen kryesisht në:

-Përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumenteve

Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura.

-Verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës dhe në rast shkeljesh të dispozitave ligjore dhe nënligjore, vendosjen e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative;

-Monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private;

-Hartimin dhe nxjerrjen e Buletinit të Njoftimeve Publike;

-Përrjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet;

-Nxitjen dhe organizimin e kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

Objekt i këtij auditimi, është vlerësimi i rregullshmërisë të operacioneve financiare, nëse ato dhe informacionet janë të gjitha të aspektit material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë subjekti Agjencia e Prokurimit Publik, përgjatë periudhës 1 janar 2015 deri më 31.08.2017.

Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime

Fushëveprimi i auditimit, u shtri në periudhën kohore që përfshinë 1.01.2015 deri më 31.08.2017, gjatë së cilës u auditua dokumentacioni lidhur me veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe të vendimmarrjes në institucionin e Agjencisë të Prokurimit Publik.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Me shkresën nr. 1206/6, datë 31.01.2013 KLSH ka dërguar në APP raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet për masa, ku janë paraqitur 4 masa organizative. Me shkresën nr. 11433/5, datë 6.02.2013, APP ka dërguar në KLSH shkresën mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Me aktverifikimin nr. 1, datë 1.12.2013, nga grupi i auditimit të KLSH, është kontrolluar zbatimi i detyrave dhe ka rezultuar se rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm kanë gjetur zbatim.

2. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të APP-së.

Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit.

Për auditimin e kësaj pike grupi i auditimit është mbështetur në ligjet vjetore të “Zbatimit të buxhetit të Shtetit”, udhëzimin organike mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, udhëzimet plotësuese vjetore, si dhe çdo akt nënligjor i nxjerrë në zbatim të tij.

2.1 Zbatimi i kritereve dhe procedurave të hartimit të planit të buxhetit.

Tabela1-Plani me ndryshime në mijë lekë

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
		Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P	Pl/F	Ndryshime	Pl/P

	Paga (600)	21,494	-1,600	19,894	27,000	-4,200	22,800	26,000	0	26,000
	Sigurime (601)	3,836	-660	3,176	4,100	0	4,100	4,100	0	4,100
	Operative (602)	19,000	0	19,000	19,200	0	19,200	19,200	0	19,200
I	Totali korente	44,330	-2,660	42,070	50,300	-4,200	46,100	49,300	0	49,300
	- Pajisje sistemi, elekt	5,500	0	5,500	5,500	-5,500	0	5,100	0	5,100
	- Pajisje zyre	500	0	500	500	0	500	900	0	900
	-Ri-inxhinierim	0	+83,064	83,064	161,437	0	161,437	142,507	0	142,507
II	Total investime	6,000	83,064	89,064	167,437	-9,700	161,937	148,507	0	148,507
I+II	Total njësie/1087001	50,330	80,404	131,134	217,737	-9,700	208,037	197,807	0	197,807

Burimi i informacionit: APP

Punoi: KLSH

Sa më sipër, arrijmë në konkluzion/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit.

- Hartimi dhe detajimi i planit të buxhetit nga Njësia shpenzuese APP, është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Mbi procedurat e zbatimit të buxhetit” me ndryshime, Kapitulli II. 2 “Buxheti i Shtetit Detajimi i fondeve buxhetore”, pika 56 dhe 59, si dhe të udhëzimeve vjetore mbi buxhetin.

- Në detajimin e fondeve janë respektuar kufijtë buxhetorë dhe limiti mujor i shpenzimeve të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Nëpunësi Autorizues i Njesisë Qendrore, si dhe afatet e dërgimit të detajimit të fondeve në MF.

2.2 Zbatimi i buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Tabela 2-Realizimi i planit të buxhetit për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2015 në 000/lekë			Viti 2016 në 000/lekë			8-Mujor 2017 në 000/lekë		
	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %
Paga (600)	19,894	19,832	99.7	22,800	22,452	98.5	-	18,043	-
Sigurime (601)	3,176	3,167	99.7	4,100	3,629	88.5	-	2,915	-
Paga + Sigurime							21,600	20,958	97.0
Operative (602)	19,000	18,912	99.5	19,200	19,151	99.7	13,500	2,955	21.8
Totali korente	42,061	41,911	99.6	46,100	45,232	98.0	35,100	23,913	68.1
Investime (231)	89,064	4,113	4.6	161,937	19,344	12.0	148,507	120,638	
-Pajisje elektronike	5,339	3,503	65.6				5,100	0	0.0
- Pajisje zyre	661	610	92.3	500	414	83.0	900	53	5.7
-Ri-inxhinierim	83,064	0	0.0	161,437	18,930	12.0	142,507	120,585	84.4
Total njësie/1087001	131,134	46,024	35.1	208,037	64,576	31.0	183,607	144,551	78.7

Burimi i informacionit: APP

Punoi: KLSH

Midis APP-së dhe MF-së është mbajtur Aktrakordimi mujor/progresiv për realizimin e shpenzimeve, si dhe Aktrakordimi vjetor për periudhën Janar-dhjetor 2015, 2016 si dhe 8 mujor progresiv për periudhën Janar-Gusht 2017. Aktrakordimi është firmosur nga Titullari i APP, në cilësinë e NA, Specialiste e financës në cilësinë e NZ, si dhe përfaqësuesi i MF, Specialisti i thesarit, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 2 datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, “Rakordimi mujor i shpenzimeve” pika 172 ku cilësohet: “Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme”.

- Për vitin 2015, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 35.1 %. Në nivelin e ulët të realizimit ka ndikuar mosrealizimi i investimeve, i cili paraqitet në masën 4.6 %, si rezultat i mosrealizimit të investimit të parashikuar për “Ri-inxhinierimin e sistemit”

në vlerën 83,064 mijë lekë. Ky projekt është financuar nga fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Po kështu me realizim në masën 65.6 % paraqitet artikulli 231 “Blerje pajisje e orendi zyre”.

- Për vitin 2016, rezulton se realizimi i planit të buxhetit në total është në masën 31 %. Në këtë mosrealizim ka ndikuar mosrealizimi i investimeve, konkretisht projekti mbi “Ri-inxhinierimin e sistemit”. Ministria e Financave bazuar në VKM në nr. 36, datë 13.07.2016 “Akordim fondi nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve” i ka alokuar APP-së një fond në vlerën 83,064 mijë lekë e trashëguar nga fondi i miratuar i viti 2015. Vlera e kontratës për këtë projekt është në shumën 161,437 mijë lekë e cila do të financohej në vitin 2015 dhe 2016. Realizimi faktik në fund të vitit 2016 rezulton në shumën 18,930 mijë lekë.
- Për 8-mujorin 2017, plani i buxhetit është realizuar në masën 78.7 %. Me nivel të ulët realizimi paraqiten shpenzimet operative në masën 21.8 % dhe Investimet për programin “Pajisje zyre” në masën 5.7 %. Investimet për programin “Ri-inxhinierim i sistemit” i nisur që në vitin 2015 në këtë vit paraqitet me realizim në masën 84.4 %.

Planifikimi i valutës:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në valutë për periudhën objekt auditimi është kryer në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli III “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve/shpenzimet në valutë”. Detajimi i tij është bërë sipas formularit të “Planit në valutë”. Formularët janë të firmosur nga NA dhe NZ. Për çdo vit është miratuar detajimi i planit në valutë nga Ministria e Financave. Përdorimi i valutës është bërë brenda kufijve të lejuar.

Tabela 3-Planifikimi dhe realizimi i Valutës

Periudha	Plani i valutës (Euro)	Fakti	
		Euro	USD
2015	7,000	3,009	
2016	3,400	786	1,169
9-M/2017	3,000	1,065	

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH

Sa më sipër arrijmë në konkluzionin/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit përveç realizimit të investimeve për projektin “Ri-inxhinierim i sistemit”, është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit. Realizimi i buxhetit për gjithë periudhën objekt auditimi paraqitet në nivele optimale. Projekti i “Ri-inxhinierim i sistemit”, i planifikuar për të përfunduar gjatë periudhës 2015-2016, është realizuar në masën 84.4 % në vitin 2017. Ky mosrealizim në kohë ka ardhur si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

2.3 Zbatimi i kriterëve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit me destinacion fondet e investimeve, argumentimi i kërkesave për transferimet dhe ndryshimet për shtesa e pakësim të fondeve për investime.

Tabela 4-Planifikimi dhe realizimi i planit të investimeve

Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2015			Viti 2016			8-Mujor 2017		
	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %	Pl/P	Fakt	F/P në %
-Pajisje elektronike	5,339	3,503	65.6	-	-	-	5,100	0	0.0
- Pajisje zyre	661	610	92.3	500	414	83.0	900	53	5.7
-Ri-inxhinierim	83,064	0	0.0	161,437	18,930	12.0	142,507	120,585	84.6
Totali 231	89,064	4,113	4.6	161,937	19,344	12.0	148,507	120,638	81.2

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH

Programimi i investimeve nga APP, është bërë në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Nga APP janë respektuar të gjitha afatet e përcaktuara në udhëzimet e mësipërme dhe shkresat e Ministrisë së Financave, mbi startimin e procesit të programimit, zhvillimin e fazave dhe përfundimin e tij. Për përgatitjen e PBA nga Titullari i APP-së janë nxjerrë urdhrat përkatës për krijimin e Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP). Nga APP janë plotësuar të gjitha pasqyrat e kërkuara, si dhe janë plotësuar fishat mbi Planifikimin e Shpenzimeve të Programit (PSHP) dhe mbi Rishikimin e Politikave të Programit (RPP). Plotësimi i tyre është bërë për të gjitha rubrikat e kërkuara, në përputhje me kërkesat e udhëzimeve përkatëse, janë të firmosura nga NA dhe EMP.

Për vitin 2015, 2016 dhe 2017, fondi i planifikuar ka qenë në shumën 6,000 mijë lekë dhe ndryshimet kundrejt planit fillestar janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Në planin e investimeve të vitit 2015, me shkresën nr. 11440/1, datë 17.08.2015, është miratuar fondi shtesë në shumën 166,128 mijë lekë nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në zbatim të vendimit të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr. 36, datë 28.07.2015 Për shpërndarjen e fondit për programin “Shqipëria dixhitale”, si më poshtë:

Tabela 5-Investime nga FZHR

Periudha	Plan + shtesa	Fakt	Diferenca	Realizimi
2015	83,064	0	83,064	0.0
-Plan	83,064			
2016	161,437	18,930	142,507	12.0
-Plan	83,064			
-Trashëguar nga 2015	78,373			
2017	142,507	120,585	21,922	84.6
-Plan	0			
-Trashëguar nga 2016	142,507			

Burimi i informacionit: APP

Punoi: KLSH

Për APP në vitin 2015 ishte planifikuar fondi në vlerën 83,064 lekë, i cili nuk u përdor dhe u trashëguar për vitin 2016, mbështetur në Udhëzimin plotësues të MF nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016” dhe shkresës së MF nr. 2891/1, datë 01.03.2016. Sipas shkresës nr. 10276/2, datë 03.08.2016 fondi i çelur në Degën e Thesarit për vitin 2016 në total është në shumën 161,437 mijë lekë (vlera 4,691 mijë lekë rezulton kursim (fondi limit-vlerën e kontratës). Realizimi i kësaj kontrate në vitin 2016 rezulton në shumën 18,930 mijë lekë.

Për vitin 2017, mbështetur në Udhëzimin plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, MF me shkresën nr. 3258, datë 21.02.2017, ka miratuar trashëgimin e fondeve të pashpenzuara në vitin 2016 për vitin 2017. Realizimi për vitin 2017 paraqitet në vlerën 120,585 mijë lekë.

Gjatë vitit 2016, plani fillestar është pakësuar në shumën 5,500 mijë lekë si rezultat i realizimit të projektit të ri-inxhinierimit dhe përfshirjes në këtë investim edhe blerje “Pajisje elektronike”, të parashikuara për t’u realizuar nga fondi i akorduar prej 5,500 mijë lekë në fillim të vitit.

Gjatë vitit 2017, rezulton një nivel më i lartë i realizimit të investimeve publike, ku peshën kryesore e zë “Projekti i Ri-inxhinierimit”.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit. Programimi, detajimi shtesat dhe pakësimet e fondeve për investime, janë

bërë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Mosrealizimi i shpenzimeve për investime gjatë vitit 2015 dhe 2016 ka patur shkaqe objektive të lidhura me dështimin e procedurës së prokurimit sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3, datë 17.03.2016, për shkak të mosparaqitjes së asnjë oferte të vlefshme dhe më pas me përsëritjen e procedurës sipas Urdhrit të prokurimit nr. 6, datë 29.04.2016, procedurë e cila është finalizuar me lidhjen e kontratës më datë 14.07.2016.

3. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

3.1 Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportimit, respektimi i afateve.

Llogaritë vjetore të APP-së janë, mbyllur dhe dorëzuar sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin të Ministrit të Ministrisë së Financave nr. 14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare Vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e Pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të Njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj” ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007, si dhe janë plotësuar në zbatim të VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësitë që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”, si dhe udhëzimit të MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” me ndryshime.

Për vitin 2016, llogaritë vjetore të APP-së janë mbyllur në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 25, datë 28.12.2016 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2016” Kapitulli V “Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera të qeverisjes së përgjithshme” pika 32 ku përcaktohet: “Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera të njësitë të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare **do të vazhdojë të kryhet në bazë të udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 dhe udhëzimit nr. 26, datë 27.12.2007 ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.02.2008**”.

Paraqitja e pasqyrave financiare është bërë sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave dorëzimi i saj është bërë brenda afateve të përcaktuara, si dhe klasifikimi i shpenzimeve është kryer sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik.

Konstatim: Baza ligjore mbi përgatitjen e pasqyrave financiare *nuk ka pësuar rregullimet e nevojshme, pasi aktet nënligjore i referohen VKM-ve të dala në zbatim të një ligji të shfuqizuar, konkretisht ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”. Kështu udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 i referohen VKM nr. 248, datë 10.04.1998, si dhe ligjit nr. 7661 datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”, ligj i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

- Plotësimi i pasqyrave financiare është paraqitur qartë dhe veçmas, bazuar në Udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe Raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet Qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj” ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 14 date 28.12.2006”.

-Llogaria vjetore e APP-së për periudhën ushtrimore 2015 dhe 2016, nga ana formale është e plotësuar sipas kërkesave dhe formatit të miratuar, janë plotësuar të gjitha pasqyrat financiare dhe relacioni shpjegues i tyre;

- Para mbylljes së llogarisë vjetore është kryer inventarizimi i përgjithshëm i pasurisë, në zbatim të procedurave, rregullave të parashikuara në Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

- Janë inventarizuar të gjitha kërkesat debitore dhe detyrimet kreditore ndaj të tretëve, llogaritë analitike përputhen me ato sintetike.

- Është kryer përlllogaritje e amortizimit të AQT të trupëzuara. Për pajisjet elektronike është aplikuar norma e amortizimit në masën 25 %, parashikuar në udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006, Kreu II “Procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2006”, Kapitulli 1 “Procedura të përgjithshme”.

-Janë mbajtur me Degën e Thesarit Tiranë akt-rakordimet përkatëse.

-Janë kryer veprimet e mbylljes

- Pasqyrat financiare janë firmosur sipas urdhrimit të NA nr. 9137/3, datë 11.08.2015, nga specialisti i financës.

Gjetje nga auditimi.

Situata:	Pasqyrat financiare të vitit 2015 dhe 2016 janë firmosur në emër të NZ, nga specialisti i financës, i cili i ka hartuar ato, sipas urdhrimit të NA, nr. 9137/3, datë 11.08.2015. Në cilësinë e NZ, në APP është znj. Xhoana Ristani e cila është në profesion “Juriste”, nuk zotëron aftësitë profesionale për miratimin e pasqyrave financiare, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” pika 1 ku përcaktohet: <i>“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike”</i> .
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e aftësive profesionale, të juristit për të vlerësuar aktivitetet financiare, për të ushtruar kontrollin mbi strukturat e varësisë etj.
Shkaku:	Emërimi në kundërshtim me ligjin.
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/ E mesme / E lartë
Rekomandimi:	Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA), të marrë menjëherë masat që zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të bëjë emërimin e NZ, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi:

Nga auditimi i përlllogaritjeve analitike mbi amortizimin e aktiveve, u konstatua se për mallra në vlerën 2,693,700 lekë në vitin 2015 dhe 2016 nuk është përlllogaritur amortizim, si dhe janë pasqyruar në pasqyrën nr. 1 të aktivitetit të bilancit me vlerën mbetur të vitit 2013.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Nga auditimi i përlllogaritjeve të amortizimit të pajisjeve IT, ka rezultuar se paraqitja e tyre në kontabilitet nuk është bërë me vlerën të mbetur, duke përlllogaritur amortizimin vjetor, deri në përfundimin e procedurave sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Kështu në pasqyrën nr. 1 të aktivitetit të bilancit, këto materiale janë paraqitur me vlerën fillestare e tyre në shumën 2,693,700 lekë dhe jo me vlerën e mbetur, pas zbritjes së amortizimit.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 me ndryshime “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare Vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e Pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të Njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007
Ndikimi/efekti:	Pasqyrim i aktiveve në vlerë më të lartë se vlera reale e tyre në 31.12.2015.
Shkaku:	Mosveprim i NZ dhe NA
Rëndësia e shkeljes:	Ulët/mesëm/lartë
Rekomandimi:	Rekomandim: Nëpunësi zbatues, i cili sipas ligjit 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 2/ë është përgjegjës për: <i>“Mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave. Sistemi i kompjuterizuar i thesarit mund të përdoret për kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve financiare të njësisë publike, bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria e Financave”</i> , të marrë masa për përlllogaritjen e amortizimit për mallrat në vlerën 2,693,700 lekë, të kryejë sistemimin kontabël dhe ta pasqyrojë në bilancin e vitit 2017.

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit në çdo aspekt material është i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit, përveç rastit të përlllogaritjes së amortizimit të pajisjeve IT, ku ka rezultuar se në pasqyrën nr. 1 të aktivitetit të bilancit, për materiale (pajisje IT) në vlerën 2,693,700 lekë janë paraqitur me vlerën e mbetur të vitit 2013 dhe jo me vlerën e mbetur të vitit 2016, pasi nuk është përlllogaritur amortizim për periudhat ushtrimore pas vitit 2013;

3.2 Mbajtja dhe plotësimi i dokumentacionit financiar kontabël;

Nga APP është mbajtur ky dokumentacion:

- Ditari i kontabilitetit në çelje të tij ka të hedhura llogaritë sipas gjendjes në fund të vitit paraardhës. Veprimet në ditar janë të regjistruara që prej datës 1 Janar deri në datë 31 Djetor. Regjistrimi i veprimeve ka ndjekur radhën kronologjike të dokumentacionit justifikues të veprimeve të kryera. Për çdo veprim kontabël janë debituar dhe kredituar llogaritë përkatëse;
- Libri i madh, ku janë të pasqyruara gjendjet e llogarive në fund të periudhës ushtrimore. Gjendja e tyre në fund rakordon me gjendjen e llog. 600, 601 dhe 602 dhe 231 sipas Aktrakordimeve me Degën e Thesarit;
- Ditari i arkës në lekë. Regjistrimet janë kryer sipas numrit rendor dhe radhës kronologjike.
- Ditari i arkës në valutë (euro/usd), ku janë regjistruar të gjitha veprimet me arkën në valutë dhe ku është vendosur edhe kursi ditor i këmbimit.
- Libri i arkës, është mbajtur për çdo muaj, në fillim të çdo muaji është regjistruar gjendja në fund të muajit paraardhës si gjendje në fillim.
- Regjistri i fletë konatabilizimeve;
- Regjistri i magazinës.
- Pasqyrat financiare

Mbajtja e dokumentacionit kontabël është në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin në dhe pasqyrat financiare”, si dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Për sa më sipër, arrijmë në konkluzion/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit. Mbajtja e dokumentacionit kontabël është në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin në dhe pasqyrat financiare”, si dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.

3.3 Zbatimi i ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të kryera përmes bankës, arkës në lekë dhe veprimet në valutë për periudhën objekt auditimi;

Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe Sigurime shoqërore (llog. 601).

- Për vitin 2015, me shkresën nr. 18083/102, datë 02.02.2015 është dërguar APP-së numri i punonjësve, bazuar në Ligjin nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, si dhe shkresës së APP-së nr. 13825/1, datë 29.12.2014, afat i cili ka qenë deri më datë 26.12.2014 sipas shkresës së MF nr. 18083, datë 24.12.2014. Me shkresën nr. 6831/1, datë 08.05.2015, APP i është miratuar shtesë për 5 punonjës. Numri i punonjësve të APP-së bëhet në total 28 punonjës. Gjithashtu, me shkresën nr. 18083/136, datë 24.02.2015 është miratuar shtesë 1 punonjës më kontratë të përkohshme, bazuar në VKM nr. 11, datë 14.01.2015 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2015”.
- Për vitin 2016, APP me shkresën nr. 1859, datë 01.02.2016 ka dërguar në MF detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2016. MF me shkresën nr. 18221/93, datë 05.02.2016 ka dërguar miratimin e numrit të punonjësve bazuar në ligjin nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016” si dhe Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.
- Për vitin 2017, me shkresën nr. 450/13, datë 19.01.2017 Ministria e Financave i ka dërguar APP-së, numrin i punonjësve definitiv, gjithsej 29 punonjës. Gjithashtu, në përgjigje të kërkesës së APP-së me shkresën nr. 1816, datë 26.01.2017, MF me shkresën nr. 17683, datë 02.02.2017

ka miratuar një punonjës me kontratë (punonjës arkivi) bazuar në VKM nr. 7, datë 11.0.12017 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme”.

Tabela 8-Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2015			Viti 2016			8-mujor 2017		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1.	Pagat (600)	19,894	19,832	99.7	22,800	22,452	98.5	21,600	18,042	97.3
2.	Sig. Shoq. (601)	3,176	3,167	99.7	4,100	3,629	88.5		2,915	
3.	Fondi i veçantë	100	0	0.0	143,897	0	0.0	143,236	0	0.0

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit kontabël, listë pagesat për periudhat (janar dhe dhjetor 2015; mars dhe shtator 2016; prill dhe korrik 2017) mbi përlllogaritjen e e pagave, sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare, tatimin mbi të ardhurat personale, etj., rezultoi se, ato janë llogaritur në bazë të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Pagat dhe shtesat mbi pagë dhe ndalesat janë llogaritur drejt. Nga auditimi u konstatua se, të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës dhe se, është respektuar struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve, duke përfshirë pagën bazë mujore, shtesën për pozicion, shtesën për vjetërsi, ndalesat për sigurimet shoqërore, shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat etj. Nga APP për vitet 2015, 2016 deri në gusht të vitit 2017, nuk ka patur përdorim të fondit të veçantë.

Mallra dhe shërbime (llog. 602).

Nga auditimi rezultoi se, veprimet e arkës në lekë dhe valutë dhe ato nëpërmjet bankës janë kryer në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësieve që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

b. Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën.

Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi, për veprimet e kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, veprimet kontabël janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Regjistrimi dhe kontabilizimi në ditar është bërë i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me ekstraktin e saj. Veprimet e kryera janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarët përkatës, në bazë të dokumentacionit justifikues. Pagesat e kryera me urdhër shpenzimi, janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Të gjithë urdhër shpenzimet janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Bashkëngjitur urdhër shpenzimit, janë dokumentet justifikues ligjorë si, urdhër prokurimi, kontrata, akt e marrjes në dorëzim, fletë hyrja, ftesa për ofertë, njoftim fituesi në rastet e likuidimit të mallrave të prokuruar. Për likuidimin e shpenzimeve si ujë, shërbime postare, energji etj, bashkëngjitur urdhër shpenzimit, është fatura tatimore. Për likuidimin e shpenzimeve për kontributet bashkëngjitur urdhër shpenzimit është urdhër pagesa për kontributet, formulari i deklaramit të kontributeve (listë pagesa).

Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim dhe dieta brenda vendit, pagesat janë përlllogaritur në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” me ndryshime, bashkëngjitur urdhër shpenzimit është urdhër shërbimi, autorizimi, fatura tatimore dhe kuponi tatimor për shpenzimet e akomodimit, biletat për shpenzimet e transportit si dhe dokumentacion tjetër justifikues.

Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, pagesat janë përlllogaritur dhe kryer në zbatim të VKM nr. VKM nr. 870, date 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013, në zbatim të tij. Bashkëngjitur urdhër shpenzimit është ftesa nga organizatorët, autorizimi i titullarit, miratimi nga institucioni qendror (KM), urdhër shërbimi, faturat e hotelit, faturat e lëvizjes me taksë (aeropot-hotel dhe anasjelltas). Çdo urdhër shpenzimi është vulosur nga Dega e Thesarit Tiranë.

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, për periudhën objekt auditimi rezultoi se, regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës me gjendjen e librit të arkës. Të gjitha mandat-arkëtimet dhe mandat-pagesat janë të firmosur nga dy palët, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Financave dhe mbështeten në dokumentet justifikues ligjorë. Nga auditimi rezultoi se, veprimet kontabël janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjendja e arkës në lekë dhe valutë në fund të çdo viti, paraqitet zero.

Sa më sipër arrijmë në konkluzionin/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shpenzimet e kryera nëpërmjet bankës dhe arkës në lekë dhe valutë, sipas dokumentacionit kontabël të audituar me zgjedhje, janë kryer në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

3.3 Inventarizimi i pronës shtetërore.

Para mbylljes së llogarisë vjetore të vitit ushtrimor 2015 dhe 2016, është kryer inventarizimi i përgjithshëm i pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhim e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

Për vitin 2015, ka rezultuar se: janë kryer të gjitha inventarizimet sipas urdhrin të inventarizimit. Gjendja e inventarit është e kuadruar sipas llogarive inventariale të pasqyruara në kontabilitet dhe aktivin e bilancit kontabël, konkretisht: posti A i bilancit “Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara”, llogaritë 212 “Ndërtime e konstruksione” në shumën 32,759,850 lekë, 214 “Instalime teknike etj” në shumën 17,974,760 lekë, 215 “Mjete transporti” në shumën 1,294,000 lekë, 218 “Inventari ekonomik” në vlerën 107,764,549 lekë, në total AQT paraqiten në shumën 159,793,159 lekë. Posti B “Aktivet qarkulluese”, llogaritë e klasës 3, llogaritë 312 “Materiale” në vlerën 97,055 lekë dhe 327 “Objekte inventari” në vlerën 744,396 lekë .

Sipas Procesverbalit të inventarizimit nr. 10020/2, datë 11.09.2015 bazuar në urdhrin e inventarizimit si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të APP-së nr. 10220, datë 09.09.2015, “Mbi ngritjen e Komisionit të inventarizimit të aktiveve të magazinës dhe të inventarit personal të punonjësve të administratës”, ka rezultuar se nuk ka diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike, gjendja kontabël dhe ajo fizike në magazinë është në shumën 5,642,490 lekë. Inventarët janë të firmosur në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përfundim është hartuar Relacioni nr. 10220/3, datë 11.09.2015.

Gjithashtu, nga komisioni është mbajtur Procesverbali nr. 10220/5, datë 28.12.2015, mbi inventarizimin e zyrave, objektit dhe inventarin sipas kartelave personale për secilin punonjës.

Sipas gjendjes së inventarit në kartelat personale dhe asaj fizike për çdo punonjës ka rezultuar se nuk ka diferenca. Gjendja kontabël dhe fizike e inventarit është e barabartë.

U konstatuan këto mangësi:

1. Në përfundim kanë rezultuar mospërputhje midis përshkrimit të pajisjeve në kartelë me ato faktike, në 7 raste, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim.
2. Nga auditimi ka rezultuar se ndodhen në magazinë pajisje jashtë përdorimi për të cilat nuk janë zhvilluar procedurat përkatëse për, vlerësimin e tyre, nxjerrjen jashtë përdorimi, asgjësimin e tyre dhe kryerjen e veprimeve kontabël.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Nga auditimi, ka rezultuar se ndodhen në magazinë pajisje jashtë funksioni për të cilat nuk janë zhvilluar procedurat përkatëse për; vlerësimin e tyre, nxjerrjen jashtë përdorimi, asgjësimin e tyre dhe daljen nga magazina.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhim e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime; ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, udhëzimi nr. 2 të MF datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” me ndryshime.
Ndikimi/efekti:	Paraqitje e aktiveve në vlerë më të lartë.
Shkaku:	Nga titullarët e APP-së, nuk janë marrë masa për të vazhduar procedurat sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011. Ulët/mesëm/lartë
Rëndësia e shkeljes: Rekomandimi:	Titullari i APP-së, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, i cili sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9, pika 4/ë është përgjegjës për; <i>“Përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar”</i> të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e komisionit të inventarizim/vlerësimit/nxjerrjes jashtë përdorimi dhe komisionit të asgjësimit të materialeve në vlerën 2,693,700 lekë, në zbatim të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

Për vitin 2016, ka rezultuar se: Nga APP është kryer në përgjithësi inventarizimi i pronës shtetërore, sipas urdhrit të inventarizimit. Gjendja e inventarit është e kuadruar sipas llogarive inventariale të pasqyruara në kontabilitet dhe aktivin e bilancit kontabël, konkretisht: posti A i bilancit “Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara”, llogaritë 212 “Ndërtime e konstruksione” në shumën 32,759,850 lekë, 214 “Instalime teknike etj” në shumën 36,904,460 lekë, 215 “Mjete transporti” në shumën 1,294,000 lekë, 218 “Inventari ekonomik” në vlerën 108,178,069 lekë, në total AQT paraqiten në shumën 179,136,379 lekë. Posti B “Aktivet qarkulluese”, llogaritë e klasës 3, llogaritë 312 “Materiale” në vlerën 74,146 lekë dhe 327 “Objekte inventari” në vlerën 752,046 lekë .

Nga Titullari i APP-së ka dalë urdhri nr. 13549, datë 06.12.2016 mbi ngritjen e komisionit të inventarizimit, ku është përcaktuar komisioni, afati i përfundimit dhe forma e raportimit.

Nga komisioni është mbajtur Procesverbali i inventarizimit më datë 27.12.2016 dhe ka rezultuar se nuk kanë rezultuar diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Ka rezultuar se nuk është kryer inventarizimi i magazinës.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhim e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime; ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, udhëzimi i MF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” me ndryshime.
Ndikimi/efekti:	Nuk ka informacion mbi gjendjen fizike të mallrave në magazinë, nëse ekzistojnë diferenca dhe pamundësia e pasqyrimin të gjendjes reale.
Shkaku:	Në procesverbalin e datës 27.12.2016 dhe Relacionit nr. 13594/1, datë 29.12.2016 drejtuar titullarit të APP-së, Komisioni është shprehur se nuk e ka kryer inventarizimin e mallrave në magazinë, pasi sipas Përgjegjëses së Magazinës, dera hyrëse e magazinës nuk mund të hapet për shkak të lagështirës.
Rëndësia e shkeljes:	Ulët/mesëm/lartë

Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit jo në çdo aspekt material është i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit, për arsye se:

- Në përfundim të inventarizimit kanë rezultuar mospërputhje midis përshkrimit të pajisjeve në kartelë me ato faktike, në 7 raste, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim.
- Nga auditimi ka rezultuar se ndodhen në magazinë pajisje jashtë përdorimi për të cilat nuk janë zhvilluar procedurat përkatëse për, vlerësimin e tyre, nxjerrjen jashtë përdorimi, asgjësimin e tyre dhe kryerjen e veprimeve kontabël, sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.
- Në fund të vitit 2016, për efekt të hartimit pasqyrave financiare, nuk është kryer inventarizimi i magazinës, vlera fizike është konsideruar e barabartë me vlerën kontabël.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, të trajtuara në pikën 3 të auditimit mbajnë përgjegjësi:

1. Z. E.A, ish Titullar i APP-së, në cilësinë e NA;
2. Znj. Xh.R., Shefe e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Financës, në cilësinë e NZ;
3. Znj. Z. L., Specialiste e Financës, dhe në cilësinë e NZ (e deleguar).

4. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në bazë të këtij ligji u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Agjensinë e Prokurimit Publik.

Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Për periudhën objekt auditimi 2015, 2016 dhe 31.08.2017, për vlerësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm u vlerësuan 5 komponentët e tij, konkretisht:

1. Mjedisi i kontrollit;
2. Menaxhimi i riskut;
3. Aktivitetet e kontrollit;
4. Informimi dhe komunikimi
5. Monitorimi

Mjedisi i kontrollit:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve. Nga vlerësimi i elementëve që përbëjnë mjedisin e kontrollit u evidentua se:

Gjetje nga auditimi:

<p>Situata:</p> <p>Kriteri:</p> <p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p> <p>Rëndësia e shkeljes:</p> <p>Rekomandimi:</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se ky institucion <u>nuk ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik</u>, i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetitë e institucionit dhe planet e veprimit.</p> <p>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa “b” i cili citon se “<i>Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë</i>”.</p> <p>Veprimtaria e APP-së, si institucioni i vetëm që rregullon procesin e prokurimit publik, ka një ndikim dhe efekt të lartë në ecurinë dhe përmirësimin e këtij procesi, kryesisht në përmirësimin e bazës ligjore dhe rregullative, ecurinë dhe përmirësimin e SPE etj, me qëllim që autoritet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, si përdorues të menaxhojnë me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet fondet publike të prokuruar. Përmirësimi i këtij sistemi kaq të rëndësishëm, i cili jo rrallë ndeshet me problematika, kërkon padyshim vendosjen e objektivave strategjike dhe një plani veprimi afatmesëm për përmirësimin e tij.</p> <p>Mosveprimi i strukturave përgjegjëse, me arsyetimin se janë pjesë e planeve të tjera strategjike (institucione të tjera)</p> <p>E ulët/E mesme/E lartë</p> <p>Titullari i APP-së duhet të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit</p>
---	--

	për një periudhë 3 vjeçare. Gjithashtu, duhet të bëhen pjesë e objektivave strategjike edhe ato pjesë të planeve strategjike të projekteve të ndryshme, ku APP është e përfshirë.
--	---

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimit, nga auditimi u konstatua se, <i>ky institucion nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, gjithashtu nuk ka kryer trajnime mbi “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”</i>
Kriteri:	<i>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.</i>
Ndikimi/efekti:	Mungesa e trajnimeve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negative për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. Gjithashtu mungesa e trajnimeve në fushën profesionale sjell ndikime në cilësinë e punës.
Shkaku:	Mosveprimi i Titullarëve të APP-së për hartimin e planeve të trajnimeve profesionale, si dhe mungesa e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave për trajnimet në fushën e “Menaxhimit financiar dhe kontrollit”.
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/E mesme/E lartë
Rekomandimi:	Titullari i APP-së të marrë masa për hatimin e planit vjetor të trajnimeve, përcaktimit të temave sipas nevojave të shprehura nga stafi, me qëllim përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së APP-së.

Menaxhimi i riskut:

Nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Nga këqyrja e regjistrit të risqeve u evidentua se:

Situata:	<p>- Nga auditimi u konstatua se, punonjësit nuk janë trajnuar mbi menaxhimin e riskut (vetëm një punonjës është trajnuar), element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe referuar kapitullit III të “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.</p> <p>- Regjistri i risqeve nuk është plotësuar sipas kërkesave, disa rubrika të tij nuk janë trajtuar në mënyrën e duhur si: aktivitetet e kontrollit ekzistuese dhe ato shpesh për minimizimin e tyre,</p>
-----------------	--

Kriteri:	procese që kanë të bëjnë me trajtimin e risikut. <i>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.</i>
Ndikimi/efekti:	Mungesa e trajnimeve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negative për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. Gjithashtu mungesa e trajnimeve në fushën profesionale sjell ndikime në cilësinë e punës.
Shkaku:	Mosveprimi i Titullarëve të APP-së për hartimin e planeve të trajnimeve profesionale, si dhe mungesa e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave për trajnimet në fushën e “Menaxhimit financiar dhe kontrollit”.
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/E mesme/E lartë

Aktivitetet e kontrollit:

Aktivitetet e kontrollit si politika dhe procedura të vendosura për të adresuar risqet dhe arritur objektivat e njësisë përfshijnë një sërë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues. APP mbi këtë komponent të sistemit të kontrollit të brendshëm ka realizuar disa

Situata:	Nga auditimi është konstatuar se, nuk janë përcaktuar procedurat mbi disa procese kryesore të punës së APP-së. Nga APP nuk është përcaktuar harta e proceseve dhe gjurma e auditimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” pika 2 ku përcaktohet: <i>“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”</i> , si dhe Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 anekset 2, 3 dhe 4. Gjithashtu mangësi ka në funksionimin e kontrolleve menaxheriale të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e objektivave të qarta si dhe punësim dhe trajnim i përshtatshëm, pasi është evidentuar mungesa e strategjisë dhe mungesa e trajnimeve të stafit.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e aktiviteteve të kontrollit ndikon në adresimin e risqeve si dhe në përcaktimin e veprimeve kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues, me qëllim minimizimin e

<p>Shkaku:</p> <p>Rëndësia e shkeljes:</p> <p>Rekomandimi:</p>	<p>risqeve dhe arritjen e objektivave.</p> <p>Mos kuptimi dhe mos vlerësimi i rëndësisë së Menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga ana e stafit dhe menaxhimit.</p> <p>E ulët/E mesme/E lartë</p> <p>Titullari i APP-së të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit, pasi ajo përfaqëson: <i>rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve</i>” dhe hartës së proceseve me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.</p>
---	--

Informimi dhe komunikimi:

Nga auditimi u arrit në konkluzionin që: Përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisive. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, duke hartuar raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Punonjësit brenda institucionit vijnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. APP ka faqen e tij zyrtare dhe nëpërmjet këtij eëbsite të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të APP-së.

Monitorimi:

Nga auditimi u arrit në konkluzionin që: Janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit dhe raportet e monitorimit vjetor të tij, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në nenin 65 “Monitorimi”, në të cilin citohet: “Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Nëpunësi autorizues z.E.A. dhe Nëpunësi Zbatues Znj.Xh.R..

5. Mbi përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandëve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;

5.1. Mendimet e dhëna nga APP, institucioneve të ndryshme:

Gjatë vitit 2015, nga auditimi i mendimeve të dhëna nga APP kundrejt kërkesave AK dhe OE për asistencë dhe mendim janë dhënë gjithsej 184 kthim përgjigje. U audituan me zgjedhje 90 raste, nga të cilat në 12 raste u evidentuan mangësi.

Gjatë vitit 2016, nga auditimi i mendimeve të dhëna nga APP kundrejt kërkesave AK dhe OE për asistencë dhe mendim janë dhënë gjithsej 136 kthim përgjigje. U audituan me zgjedhje 65 raste, nga të cilat në 9 raste u evidentuan mangësi.

Gjatë 8-mujorit 2017, nga auditimi i mendimeve të dhëna nga APP kundrejt kërkesave AK dhe OE për asistencë dhe mendim janë dhënë gjithsej 91 kthim përgjigje. U audituan me zgjedhje 45 raste, në të cilat nuk u evidentuan mangësi.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Nga auditimi u konstatua se në 12 raste të kthimit të përgjigjeve APP nuk ka dhënë sqarime, interpretim, orientim apo përgjigje shteruese për AK apo OE. Në këto raste APP është mjaftuar me përgjigjen të natyrës “zbato ose referoju ligjit”, si dhe ka kthyer përgjigjet në tejkallim të afateve kohore të përcaktuara.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, neni 13, pika 2/d “Në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi”
Ndikimi/efekti:	Vendimi nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore”. Mungesa e një orientimi të drejtë dhe ligjor nga ana e APP-së, mund të shkaktojë konfuzion, vonesë dhe veprime të gabuara të AK gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Gjithashtu moskthimi i përgjigjeve në afat ndikon në realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik gjë e cila mund të sjellë pasoja në kryerjen e punëve publike, shërbimeve apo blerjen e mallrave nga AK.
Shkaku:	Mosveprimi i APP, në përputhje me kërkesat e ligjit, neglizhencë në shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e përgjigjeve sqaruese dhe shteruese.
Rëndësia e shkeljes:	Ulët/mesëm/lartë
Rekomandimi:	Titullari i APP-së, të marrë masa për ndërprerjen e praktikave të tilla, kthimin e përgjigjeve sqaruese ndaj AK, si dhe në rastet e kërkesave të përsëritura për një çështje të caktuar, të publikojë mendimin dhe interpretimin e saj, me qëllim bërjen me dije gjithë AK.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. E. A, znj. K.E., znj. D.E., znj. R.K., z. F.Ç., znj. A.D. dhe znj.G. P..

5.2. Nga këqyrja e bazës ligjore të fushës së prokurimeve publike në raport me ligjin, si VKM-të dhe udhëzimet në zbatim të tyre rezultoi se ka nevojë për përmirësime sa më poshtë:

Vendimi nr. 914, datë 29.12.2014 “për rregullat prokurimit publik” me ndryshime.

- **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është evidentuar se në nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, paragrafi I, nuk del qartë fakti se cili është kufiri i lejueshëm i gabimeve materiale, për të cilat autoritetet kontraktore e pranojnë një ofertë si të vlefshme.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, paragrafi I, të ndryshojë:

Është: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Të bëhet: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta se plus/minus 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

- **Gjetje nga Auditimi.** Nga auditimi është evidentuar fakti se përcaktimi në nenin 15 të VKM-së “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pjesa ku shprehet për kandidatët apo ofertuesit e huaj, krijon pabarazi dhe diskriminim ndaj operatorëve ekonomikë vendas. Në nenin 15 përcaktohet: “...Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, një vetëdeklaratë me shkrim”, ç’ka vjen në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi” germa d, e LPP-së, ku përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të ndryshohet:

Është: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 45 të LPP. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, një vetëdeklaratë me shkrim.

Të bëhet: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 45 të LPP. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, dokumente të ngjashme që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të kërkuara të shoqëruara me një vetëdeklaratë me shkrim.

Udhëzime të nxjerra nga APP për vitet 2015, 2016 deri më 31.08.2017.

Agjencia e Prokurimit publik në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015 dhe Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016”, neni 83, harton udhëzime dhe manuale shpjeguese për tu ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit. Gjatë vitit 2015 APP ka nxjerrë 15 udhëzime, në vitin 2016 ka nxjerrë 3 udhëzime dhe në vitin 2017 deri në 31.08.2017 ka nxjerrë 6 udhëzime ndër të cilët rezultuan me parregullsi si më poshtë:

1. Nga auditimi i Udhëzimit nr. 1, datë 27.01.2015 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, nga organi qendror blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë." u konstatuan parregullsi si më poshtë :

Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, nga organi qendror blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë" është evidentuar:

a. Në nenin 1 të udhëzimit, pika 1, germa (ë), nuk është përshkruar në përputhje me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime".

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: "Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike:

Të bëhet: "Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike, përveç filtrave të automjeteve".

b. Në nenin 2 të udhëzimit, nuk është përcaktuar afati i paraqitjes së kërkesave nga autoritetet kontraktore, sipas përcaktimit të bërë në VKM nr. 28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime" pika 3).

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: "Autoritetet kontraktore dërgojnë pranë Organit Qendror Blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, me anë të një kërkesë të veçantë të bërë në formë shkresore dhe elektronike, nevojat për mallrat dhe shërbimet e sipërpërmendura, ku përcaktohen specifikimet teknike, sasitë e mallrave ose shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe vlerën e përllogaritur (pa TVSH)."

Të bëhet: "Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, specifikimet teknike, sasitë e mallrave ose shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe vlerën e përllogaritur (pa TVSH)".

2. Nga auditimi i Udhëzimit nr. 2, datë 27.01.2015 "Për hartimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrimit të Realizimeve të Prokurimit Publik" u konstatuan parregullsi si më poshtë:

Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin nr. 2, datë 27.01.2015 "Për hartimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrimit të Realizimeve të Prokurimit Publik" pika 3, paragrafi I, nuk është trajtuar saktë, pasi nëse nuk është organ varësie do të thotë që është organ qendror dhe afati i përcaktuar për dërgimin e regjistrimit të parashikimeve në APP, për organet qendrore është data 31 Janar, e cila është përcaktuar në pikën 2 të udhëzimit.

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: "Nëse autoriteti kontraktor nuk është organ varësie, regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i hartuar dhe i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor do të dërgohet për publikim në APP brenda datës 15 janar të çdo viti".

Të bëhet: "Nëse autoriteti kontraktor është organ qendror, por nuk ka organe në varësi, regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i hartuar dhe i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor do të dërgohet për publikim në APP brenda datës 15 janar të çdo viti".

e dërgon regjistrin brenda datës 15 janar, pra në të dy rastet i drejtohet Institucioneve qendrore.

3. Nga auditimi i udhëzimit nr. 6, datë 27.01.2015 “Për Përdorimin e marrëveshjes kuadër” u konstatuan parregullsi si më poshtë:

Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin nr. 6, datë 27.01.2015 “Për Përdorimin e marrëveshjes kuadër”, nuk janë përcaktuar saktë referencat ligjore mbi të cilat ka dalë ky udhëzim.

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 83, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të bëhet: Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 83, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, *Kreu V, nenet 41,42,43,44,45,46,47.*

4. Nga auditimi është evidentuar që në udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” pika 1, por edhe në ndonjë akt tjetër nënligjor të prokurimeve publike, nuk është përcaktuar se si do të vepronë autoritet kontraktore në rastet e tjera të pritje përcjelljeve të delegacioneve të huaja të cilat nuk janë përfshirë në “protokollin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”.

Sa më sipër rekomandojmë:

a. Udhëzimi nr. 1, datë 21.01.2016, pika 1:

Është: Në fund të pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përrjashtimisht, kjo procedurë prokurimi përdoret edhe për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, ku vlera e përllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup-artikujsh brenda një viti kalendarik, është nën vlerën e kufirit të ulët monetar”.

Të bëhet: Në fund të pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Përrjashtimisht, kjo procedurë prokurimi përdoret për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, *si dhe për pritje përcjellje dhe trajtimin që ju bëhet delegacioneve të huaja*”, ku vlera e përllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup-artikujsh brenda një viti kalendarik, është nën vlerën e kufirit të ulët monetar”. Autoritetet kontraktore do të mbajnë procesverbalin sipas formularit 5/1, bashkëngjitur udhëzimit.

b. Udhëzimi nr. 1, datë 21.01.2016, Shtojca/Formulari nr. 5/1

Është: “Procesverbal për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së ceremonialit zyrtar”

Të bëhet: “Procesverbal për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së pritje përcjelljeve të delegacioneve të huaja”.

5.3. Vendimet e gjykatave:

Gjatë vitit 2015, Agjencia e Prokurimit Publik është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga operatorë ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet publike apo zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit ose nga rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Gjatë vitit 2015 APP ka ndjekur 115 çështje gjyqësore, në të gjitha fazat sipas ecurisë së tyre.

Gjatë vitit 2016, Agjencia e Prokurimit Publik është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit, nga raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe në procese

gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë. Gjatë vitit 2016 APP ka ndjekur 108 çështje gjyqësore, në të gjitha fazat sipas ecurisë së tyre.

Gjatë vitit 2017, Agjencia e Prokurimit Publik deri në periudhën 31.08.2017, është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënur me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit, nga raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe në procese gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë. Gjithsej në vitin 2017, nga APP janë ndjekur 69 çështje gjyqësore, në të gjitha fazat sipas ecurisë së tyre.

Për sa më sipër arrijmë në konkluzionin që: Nga APP, janë ndjekur të gjitha shkallët e ankimit të vendimeve të Gjykatave të cilat kanë qenë kundër APP-së, deri në marrjen e vendimeve të formës së prerë.

5.4. Projekt-Propozimet për rregullat e Prokurimit Publik, Ankandeve Publike dhe atyre në fushën e Koncesioneve/Partneriteteve:

Gjetje nga auditimi:

<p>Situata:</p>	<p>U konstatua se APP, me përjashtim të ndryshimeve e VKM-së nr. 914, datë 29.2.2014 me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 në asnjë nga praktikat e tjera nuk ka të dokumentuar hartimin e projekt propozimeve, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës dhe deri te përcjellja për në Këshillin e Ministrave të këtyre Projekt Propozimeve. Sipas sektorit Juridik të APP-së propozimet për ndryshimin e akteve të ndryshme ligjore përcillen përmes e-mail drejt Këshillit të Ministrave por nuk ka asnjë shkresë se si janë hartuar këto propozime.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 13/a ku përcaktohet: “Paraqet në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit” dhe Rregullore “Për organizimin e punës në APP” neni 4 dhe neni 5.</p>
<p>Shkaku:</p>	<p>Sipas sektorit Juridik të APP-së propozimet për ndryshimin e akteve të ndryshme ligjore përcillen përmes e-mail drejt Këshillit të Ministrave por nuk ka asnjë shkresë se si janë hartuar këto propozime.</p>
<p>Rëndësia e shkeljes: Rekomandimi:</p>	<p>Ulët/mesëm/lartë Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik, duhet të marrë masa për krijimin e praktikave ligjore, të dokumentojë hartimin e projekt-propozimeve për prokurimin publik duke filluar që nga ngritja e grupit të punës, iniciativën ligjore dhe deri tek përcjellja e tyre për në Këshillin e Ministrave.</p>

Për sa me sipër ngarkohet me përgjegjësi: Titullarët e APP-së, pasi në zbatim të rregullores së APP neni 4, pika 8, është përgjegjës për propozimin e ndryshimeve të akteve ligjore dhe nënligjore ekzistuese apo hartimin e projekteve të reja ligjore dhe nënligjore dhe Drejtorët e Drejtorisë Juridike të cilët në zbatim të nenit 5, pika 10, të Rregullores së APP-së, i paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm rekomandime për ndryshime ligjore ose akteve nënligjore, gjithashtu përgjegjësit e sektorëve Juridik dhe Sektorit të Monitorimit.

6. Mbi verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës:

6.1 Verifikime të kryera gjatë periudhës objekt auditimi, kriteret e përdorura në përzgjedhjen e tyre.

APP, ka kryer verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në zbatim të neneve 13, pika 2/g/i, 65, 66 dhe 72 pika 2 të LPP-së. Monitorimi i procedurave të prokurimit publik është iniciuar nga APP si dhe nga denoncimet e ardhura nga të tretë. Për realizimin e këtij detyrimi ligjor nga Titullari i APP-së janë hartuar planet e monitorimit të procedurave të prokurimit pas lidhjes së kontratës.

Si kriter për përzgjedhjen e procedurave të prokurimit objekt monitorimi, është marrë në konsideratë:

- lloji i procedurës së prokurimit dhe shkalla e transparencës që kjo lloj procedure ofron;
- vlera limit e kontratës;
- natyra e objektit të prokurimit, kompleksiteti që paraqet;
- ofertë afër ose e barabartë me vlerën limit të kontratës;
- ankimet e operatorëve ekonomikë në APP;

Tabela nr. 9-Prokurime të kryera në sistemin e APP-së.

Lloji i procedurës	Viti 2015 në 000/lekë		Viti 2016 në 000/lekë		8M-2017 në 000/lekë	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Shërbim konsulence	168	2,391,700	153	1,877,694	59	1,074,266
I hapur ndërkombëtar	9	5,138,742	15	7,600,500	8	5,811,165
I hapur lokal	1533	74,300,872	1835	89,539,095	1374	63,012,649
Kërkesë për propozim	2914	8,846,410	3106	9,231,447	2099	5,467,913
I kufizuar lokal	1	4,240	0	0	0	0
Negocim me shpallje	5	24,412	0	0	0	0
Procedura vlerë të vogël	22435	10,261,006	21914	7,535,592	14838	4,939,215
Negocim pa shpallje	2706	8,734,240	2186	8,155,169	2120	6,503,747
Marrëveshje kuadër	34	354,179	46	1,058,299	28	249,062
MK-minikontrata	139	141,692	490	290,562	0	0
Ankande publike	220	1,313,358	147	7,058,911	96	471,158
Koncesione/PPP	11	-	5	-	13	-

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH




Tabela nr. 10-Monitorime të kryera

Lloji i procedurës	Numri i monitorimeve
--------------------	----------------------

	2015		2016		2017	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Negocim pa shpallje	16	20	27	21	10	21
Procedurë e hapur	25	30	17	20	6	10
Kërkesë për propozim	1	3	1	3	-	2
Prokurim në vlerë të vogël	4	14	6	12	-	6
Shërbim konsulence	-	-	-	-	-	1
Totali	46	67	51	56	16	40

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH

Për vitet 2015 dhe 2016 janë hartuar dhe miratuar përkatësisht nga dy plane monitorimi, ku janë përfshirë procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, të përcaktuara nga vetë APP, si dhe të iniciuara referuar denoncimeve të ndryshme të paraqitura në APP dhe portalin eëë.stopkorrupsionit.al.

Për vitin 2017, është miratuar plani i monitorimeve, ku janë përfshirë procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore. Gjatë viti 2017 janë planifikuar për t'u monitoruar 10 procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe 6 procedura prokurimi të llojit “procedurë e hapur”.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	<p>- Referuar të dhënave të mësipërme, numrit të procedurave të kryera në SPE, si dhe atyre jashtë sistemit, evidentohet se AK gjatë viteve 2015, 2016 deri në gusht 2017, kanë realizuar një numër të konsiderueshëm procedurash “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, të cilat në raport me procedurën “tender i hapur” në vitin 2015 rezultojnë të jenë 1.8 herë më shumë, në vitin 2016 rezultojnë të jenë 1.2 herë më shumë dhe në janar-gusht 2017 rezultojnë 1.5 herë më shumë.</p>
Kriteri:	<p>- Gjithashtu, APP gjatë periudhës objekt auditimi, nuk ka kryer asnjë hetim administrativ (monitorim), për “Marrëveshjet kuadër” “Koncesionet/PPP” dhe “Ankandet publike”.</p> <p>- Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” me ndryshime, neni 11 ku përcaktohet: <i>“Agjencia e Prokurimit Publik Agjencia e Prokurimit Publik kryen detyrat e mëposhtme: a) monitoron respektimin e procedurave konkurruese të koncesioneve /partneriteteve publike private, sipas legjislacionit për prokurimet publike, pas nënshkrimit të kontratës dhe, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjopa ose propozon marrjen e masave administrative; b)përfshihet një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik, nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve /partneriteteve publike private; c) kryen publikimin e dokumenteve standarde të tenderit”;</i></p> <p>- Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” me ndryshime neni 7 ku përcaktohet: <i>“Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand publik” 1. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand dhe shqyrtimi administrativ i ankesave ndaj tyre bëhen nga Agjencia e Prokurimit Publik. 2. Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e funksioneve për</i></p>

	<p><i>ankandet, ka këto kompetenca: a) u kërkon autoriteteve shitëse raportime periodike, një herë në 6 muaj, për ankandet publike të realizuara dhe zbatimin e procedurave të tyre; b) verifikon zbatimin e procedurave të ankandëve publike, në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve shitëse të gjithë informacionin e nevojshëm; c) i propozon autoritetit shitës marrjen e masave disiplinore dhe vendos gjopa nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji; ç) bën shqyrtimin administrativ të ankesave të ofertuesve në lidhje me procedurat e shitjes me ankand publik; d) vendos dhe shpall përjashtimin 1 deri në 3 vjet nga procedurat e ankandit publik të ofertuesve, të cilët gjatë një procedure shitjeje kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë; dh) raporton një herë në 6 muaj pranë Këshillit të Ministrave për kontratat e shitjes, të realizuara me ankand publik”;</i></p> <p>- Rregulloren nr. 1, datë 01.02.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e APP-së”, neni 9 pika 1 ku përcaktohet: “<i>APP Monitoron procedurat e prokurimit, koncesioneve/PPP, dhe ankandëve publike të kryera nga autoritetet kontraktore</i>”.</p>
<p>Ndikimi/efekti:</p>	<p>Nga APP, nuk është mbuluar në masën e duhur monitorimi i procedurave sipas fushës dhe llojit të tyre, ç’ka ndikon në mos identifikimin e shkeljeve, mangësive si dhe marrjen e masave ndaj AK, por më së shumti për të evidentuar mangësitë e legjislacionit, procedurave, dokumenteve dhe marrjen e masave dhe përmirësimeve të tyre për të ardhmen.</p>
<p>Shkaku:</p>	<p>Sipas ballafaqimeve të kryera me stafin dhe drejtuesit e APP, një faktor kryesor ka qenë numri i vogël i specialistëve, në krahasim me numrin e procedurave që kryhen, llojshmërinë e tyre (prokurime, koncesione, ankande). Aktualisht APP, ka në organikë të saj në sektorin e monitorimeve 6 specialistë dhe përgjegjës të sektorit. Numër i pamjaftueshëm për të realizuar në nivelin e duhur mbulimin me monitorime të procedurave të prokurimit, koncesioneve dhe ankandëve.</p>
<p>Rëndësia e shkeljes: Rekomandimi:</p>	<p>Ulët/mesëm/lartë</p> <p>Nga titullari i APP-së të merren masa për një organizim më të mirë dhe më gjithëpërfshirës të planit të monitorimeve, me qëllim mbulimin e të gjitha llojit të procedurave në proporcion me numrin, rëndësinë, fondet, riskun që paraqesin të fushës së prokurimeve, koncesioneve dhe ankandëve publike.</p>

Për sa më sipër arrijmë në konkluzionin/opinionin që: APP, sipas gjykimit të KLSH-së, ka përcaktuar kritere të drejta vlerësimi për përzgjedhjen e procedurave të prokurimit objekt monitorimi. Përsa i përket planifikimit të monitorimeve sipas fushës, APP nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit, ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” me ndryshime, neni 11; ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” me ndryshime neni 7; Rregulloren nr. 1, datë 01.02.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e APP-

së”, neni 9 pika 1, pasi nuk ka kryer asnjë monitorim mbi koncesionet, ankandet publike dhe marrëveshjet kuadër.

Në përfundim të procesit të monitorimit, në rastet kur janë konstatuar shkelje të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, nga APP ka marrë vendim për dënim me gjobë ose ka propozuar marrjen e masës disiplinore, ndaj personave përgjegjës. Të dhënat statistikore mbi masat administrative të dhëna nga APP, në përfundim të procesit të monitorimit, nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të monitoruar, paraqiten në vijim:

Tabela nr. 11-Masa të dhëna nga APP, si rezultat i monitorimeve.

Roli i zyrtarit	Autoritete kontraktore					
	Gjoha			Masa disiplinore		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Titullar i AK	10	17	9	0	2	3
Njësia e prokurimit	10	21	15	18	12	10
KVO	22	19	13	6	9	7
Grupi i punës së përllogaritjes së vlerës limit të kontratës	10	6	3	3	1	3
Komisioni i blerjeve të vogla	1	0	0	6	10	6

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH

6.2 Rezultatet nga verifikimet, vendosja e gjobave ose propozimi për marrjen e masave administrative si dhe përputhja e tyre me shkeljet e dispozitave ligjore dhe nënligjore:

- APP, është institucioni qendror përgjegjës në vend për mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandit publik.
- Veprimtaria e saj bazohet në ligjin nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe ligjin nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore e rregullative në zbatim të tyre.

Nga auditimi me zgjedhje i 15 vendimmarrjeve të APP-së dhe praktikave përkatëse, për periudhën objekt auditimi ka rezultuar se në 14 prej tyre janë konstatuar mangësi, të cilat për çdo praktikë vendimmarrje paraqiten më poshtë:

Tabela nr. 12-Praktikat e audituara

Periudha	Hetimet administrative sipas Autoriteteve Kontraktore
Viti 2015	
1	Sipas shkresës nr. 10662, datë 30.09.2014, drejtuar “Portit Detar Shëngjin” sha.
2	Sipas shkresës nr. 2187, datë 10.02.2015, drejtuar Bashkisë Elbasan.
3	Sipas shkresës nr. 2291, datë 11.02.2015, drejtuar MAS.
4	Sipas shkresës nr. 2214, datë 11.02.2015, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB)
5	sipas shkresës nr. 2216 datë 11.02.2015, drejtuar Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Viti 2016	
1	Sipas shkresës nr. 3562 datë 02.03.2016, drejtuar Posta Shqiptare sha.
2	Sipas shkresës nr. 3561 datë 02.03.2016, drejtuar Bashkisë Rrogozhinë.
3	Sipas shkresës nr. 3567, datë 02.03.2016, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.
4	Sipas shkresës nr. 9703 datë 12.08.2016, drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.
5	Sipas shkresës nr. 10932 datë 30.09.2015, drejtuar Ujësjellës Kanalizime sha Durrës.
Viti 2017	
1	Sipas shkresës nr. 6534, datë 28.04.2017, drejtuar Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2	Sipas shkresës nr. 12341, datë 28.10.2016, drejtuar Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”.
3	Sipas shkresës nr. 6525, datë 28.04.2017, drejtuar Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë “Bilal Golemi”.
4	Sipas shkresës nr. 12340, datë 28.10.2016, drejtuar Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë.
5	Sipas shkresës nr. 6536, datë 28.04.2017, drejtuar Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan.

Burimi i informacionit: APP
Punoi: KLSH

Mangësitë e evidentuara:

- Në përgjithësi nga specialistët e Sektorit të Monitorimeve të ngarkuar me kryerjen e hetimit administrativ të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK pas lidhjes së kontratës, janë evidentuar shkeljet dhe mangësitë gjatë zhvillimit të procedurës, si dhe është përcaktuar dhe cituar drejtë baza ligjore;
- Përsa ju përket vendosjes së përgjegjësive kundrejt strukturave dhe personave të ngarkuar me ligj, ka pasaktësi. Në disa raste (trajtuar hollësisht në PRA), nga specialistët përcaktohet mangësia, baza ligjore e shkelur por personat përgjegjës “këshillohen” si dhe në diapozitivin e vendimit me raste nuk përmenden, etj;
- Përsa i përket dispozitivit të vendimeve, rezulton se nuk ka asnjë argument mbi vendosjen e masës përkatëse;
- Përsa i përket vendosjes së masave administrative apo disiplinore për strukturat e përfshira në kryerjen e procedurave të prokurimit publik në AK ka rezultuar se vendimmarrja nuk ka qënë në raport të drejtë referuar shkeljeve dhe vlerës limit të kontratës.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	<p>Përcaktimi i masave administrative dhe disiplinore nga APP, nuk është bërë në përputhje me shkeljet e konstatuara dhe vlerën limit të kontratës. Përsa i përket argumentimit të pasojave që shkeljet mund të sjellin në procedurat e prokurimit të hetuara nga APP, kjo e fundit në të gjitha rastet është shprehur se: “shkeljet e evidentuara nuk kanë sjellë pasoja”, për rrjedhojë kriteri mbi të cilin duhej të zbatohet masa administrative është vlera limit e kontratës. Nga auditimi ka rezultuar se në dhënien e masave administrative nuk është zbatuar asnjë kriter i cili të jetë relatuar gjatë shqyrtimit të praktikës apo në dispozitivin e vendimit të APP-së, në asnjë procedurë ligjore apo rregullore/udhëzues të përcaktuar nga vetë APP.</p> <p>Për sa më sipër, argumentojmë se në vendimet e mëposhtme për shkelje të nenit 53, pika 3, referuar vlerës limit të kontratës masat administrative nuk janë në proporcionalitet. Konkretisht:</p> <p>Vendimi nr. 132, datë 05.12.2014 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës 41,531,008 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 300,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 94, datë 14.09.2015 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës 500,000,000 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së nuk është marrë masë administrative apo disiplinore, por i është “tërhequr vëmendja” AK.</p> <p>Vendimi nr. 40, datë 27.04.2015 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës 37,500,000 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masë disiplinore për secilin anëtar. (Argumenti shkelja nuk ka sjellë pasoja).</p> <p>Vendimi nr. 52, datë 07.05.2015 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 116,722,500 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 700,000 lekë për secilin anëtar.</p>
-----------------	--

<p>Kriteri:</p>	<p>Vendimi nr. 39, datë 31.05.2016 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 12,990,000 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 70,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 24, datë 14.04.2016 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 13,181,800 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 100,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 94, datë 31.10.2016 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 10,000,000 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 200,000 lekë për Titullarin e AK, i cili ka marrë atributet e KVO-së.</p> <p>Vendimi nr. 1, datë 07.01.2016 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 105,000,000 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 150,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 65, datë 21.07.2017 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 12,781,040 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 50,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 14, datë 31.01.2017 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 19,784,000 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë propozuar titullarit të AK masë disiplinore për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 19, datë 31.01.2017 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 117,339,018 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 150,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Vendimi nr. 54, datë 28.06.2017 i APP-së, për procedurën me vlerë limit të kontratës në shumën 249,296,950 lekë, për shkelje të nenit 53/3 të LPP-së, ndaj KVO-së është marrë masa administrative 200,000 lekë për secilin anëtar.</p> <p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, neni 72 pika 1/1, ku përcaktohet: <u>“Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlogarit të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.</u></p> <p>Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit” përcaktohet se:</p> <p><i>“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:</i></p> <p><i>a) është i parashikuar me ligj;</i></p> <p><i>b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;</i></p> <p><i>c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi;</i></p>
------------------------	--

<p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p> <p>Rëndësia e shkeljes:</p>	<p><u>ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.</u></p> <p>Mos vlerësimi i shkeljeve dhe mangësive të evidentuara dhe mos vendosja e masave administrative në raport me vlerën limit të kontratës, ndikon në mos ndëshkueshmërinë e veprimeve mbi parimin e proporcionalitetit dhe paanshmërisë, duke demotivuar AK.</p> <p>Mungesa e procedurave të shkruara (gjurma e auditimit dhe harta e proceseve) që duhet të ndiqen nga specialistët e APP gjatë procesit të monitorimit, kriteret, elementët si dhe ku duhet të mbështeten për vlerësimin e shkeljeve, mangësive si dhe vlerësimin e tyre në raport me to dhe vlerën limit të kontratës, gjë e cila edhe në ligj nuk është e përcaktuar se cili është raporti.</p> <p>E ulët/E mesme/E lartë</p>
--	---

Gjetje nga auditimi:

<p>Situata:</p> <p>Kriteri:</p> <p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p>	<p>Në trajtimin dhe evidentimin e shkeljeve të autoriteteve kontraktore, në të gjitha rastet e mësipërme nga ana e specialistëve të monitorimit, gjatë trajtimit të tyre dhe nxjerrjes së përgjegjësive është aplikuar rëndom “Tërheqje vëmendje” apo “Këshillim”. Së pari, në ligj nuk parashikohet “Tërheqja e vëmendjes” apo “Këshillimi” si masë, pas përfundimit të hetimit administrativ. Për më tepër APP, ka të drejtën e ushtrimit të këshillimit në zbatim të LPP-së, neni 13, pika 2/d ku përcaktohet: “Në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi”.</p> <p>Së dyti, këshillimet dhe tërheqja e vëmendjes, nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë konkluzioni përgjithësues dhe që t’i shërbejë në të ardhmen AK, por janë tërheqje vëmendje dhe këshillime ndaj AK, në raste kur nuk janë zbatuar nene të ndryshme të ligjit apo akteve rregullative, për të cilat në disa raste ligji parashikon penalitet përkatëse apo dhënie të masave disiplinore.</p> <p>Ligji nr. 9643, datë 29.12.2007 me ndryshime, neni 66 “Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ”, pika 1 ku cilësohet: <i>“Pas përfundimit të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:</i> <i>a) të mbyllë hetimin, në qoftë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor nën hetim nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji;</i> <i>b) të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë, në përputhje me nenin 72 të këtij ligji, për shkeljet e gjetura”.</i></p> <p>Mos ndëshkueshmëria si dhe përdorimi i standardeve të dyfishta në vlerësimin përgjegjësive në raport me shkeljet dhe personat përgjegjës sjell demotivim të AK në zbatim të ligjit, si dhe nuk dekurajon veprimet jo ligjore të tyre.</p> <p>Mungesa e procedurave të shkruara (gjurma e auditimit dhe harta e</p>
---	---

	<p>procese) që duhet të ndiqen nga specialistët e APP gjatë procesit të monitorimit, kriteret, elementët si dhe ku duhet të mbështeten për vlerësimin e shkeljeve, mangësive si dhe vlerësimin e tyre në raport me to dhe vlerën limit të kontratës, gjë e cila edhe në ligj nuk është e përcaktuar se cili është raporti.</p>
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/E mesme/E lartë

Gjetje nga auditimi:

Situata:	<p>Pothuajse në të gjitha rastet kur shkeljet kanë rezultuar në nivel më të lartë është dhënë masë administrative dhe në rastet e tjera “Masa disiplinore”. Gjatë ballafaqimeve me specialistët e APP-së, gjatë takimit përmbyllës edhe nga Titullari i APP-së, por dhe në observacionet e paraqitura argumentohet se “Masa disiplinore” është më ndëshkuese se “Masa administrative”. Nga auditimi ka rezultuar se faktet janë në kundërshtim me qasjen e APP-së, të shprehur me fjalë. Pothuajse në të gjitha rastet kur shkeljet dhe mangësitë janë konsideruar më të rënda nga APP janë aplikuar masat administrative të parashikuara në nenin 72 të LPP-së, pavarësisht raportit të tyre më vlerën limit të kontratës.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 29.12.2007 me ndryshime, neni 66 “Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ”, pika 1 ku cilësohet: <i>“Pas përfundimit të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:</i> <i>a) të mbyllë hetimin, në qoftë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor nën hetim nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji;</i> <i>b) të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë, në përputhje me nenin 72 të këtij ligji, për shkeljet e gjetura”.</i></p>
Ndikimi/efekti:	<p>Aplikimi i masave administrative apo disiplinore jo në përputhje me shkeljet dhe mangësitë e evidentuara, përdorimi i standardeve të dyfishta në vlerësimin e tyre ndikojnë në demotivimin e strukturave të AK që realizojnë prokurimet publike.</p>
Shkaku:	<p>Ky konfuzion vjen për shkak se APP nuk ka të përcaktuar asnjë standard, procedurë, kriter vlerësimi, element ku mbështeten për përcaktimin e shkallës së shkeljeve të AK, si dhe raportit të tyre me masat administrative apo disiplinore. Në dispozitivin e vendimeve të mësipërme nuk ka asnjë rresht mbi konkluzionet e dala nga hetimi administrativ, si dhe ku mbështeten në dhënien e masave.</p>
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/E mesme/E lartë

Gjetje nga auditimi:

Situata:	<p>APP në vendimet e saj, ka argumentuar se pavarësisht shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore, nuk kanë rezultuar pasoja dhe bazuar në këtë fakt janë dhënë masat ndaj autoriteteve kontraktore. Konkretisht për shkelje të nenit 53 pika 3 të LPP-së, ku AK kanë kualifikuar operatorë ekonomike të cilët nuk kanë plotësuar kriteret kualifikuese, mbahen qëndrime të ndryshme, duke ju referuar kriterëve të</p>
-----------------	--

	<p>paplotësuar nga operatorët ekonomikë, gjë që vjen në kundërshtim me ligjin “Për prokurimin publik”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, DST ku mosplotësimi i një kriteri kualifikues është i mjaftueshëm për s’kualifikimin OE nga gara, nuk përcaktohet që një kriter kualifikues prevalon mbi tjetrin. Për rrjedhojë gjykimi i specialistëve të APP-së mbi rëndësinë e kriterëve nuk ka mbështetje ligjore.</p>
Kriteri:	<p>Ligji 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” me ndryshime, neni 53 dhe 55 VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime;</p>
Ndikimi/efekti:	<p>Dokumentet standarde të tenderit Mos vlerësim i drejtë i shkeljeve të kryera nga AK, ndikon në motivimin e strukturave që janë të përfshirë në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe dekurajimin e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin.</p>
Shkaku:	<p>Mosveprimi i specialistëve në përputhje me ligjin, përdorimi i të drejtës së tyre diskreacionale jo në përputhje me ligjin.</p>
Rëndësia e shkeljes:	<p>E ulët/E mesme/E lartë</p>

Për përmirësimin e situatës në të ardhmen referuar gjetjeve të mësipërme rekomandojmë:

Rekomandimi:	<p>Titullari i APP-së të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e rregullores së procedurave/manual/udhëzim mbi të cilin duhet të mbështeten specialistët e APP-së gjatë kryerjes së hetimit administrativ (monitorimit), ku të përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkalla hierarkike e zhvillimit të procedurës që nga nxjerrja urdhrit deri tek vendimi, personat që do të përfshihen në monitorimin e një praktike si dhe përgjegjësitë e tyre referuar trajtimit të çështjes dhe vendimmarrjes; - Të përcaktohet shkalla e masës administrative në raport me vlerën limit të kontratës, duke u mbështetur edhe në aktet tjera ligjore që rregullojnë këtë procedurë; - Të përcaktohet shkalla e shkeljeve sipas rëndësisë së tyre, cilat do të konsiderohen shkelje që sjellin pasoja dhe cilat janë shkelje që nuk sjellin pasoja; - Të përcaktohen se cila prej masave që parashikon ligji për t’u aplikuar është më ndëshkuese, masa administrative apo masa disiplinore; - Të përcaktohet formati dhe rubrikat apo kapitujt që duhet të përmbajë vendimi i monitorimit; - Të përcaktohet paraprakisht hartimi i një projektvendimi, ku të paraqiten propozimet e specialistëve mbi masat ndaj AK, i cili me miratim me/ose pa vërejtje nga ana e titullarit të kalohet në vendim. - Të parashikohet mënyra e trajtimit të rasteve kur mangësitë e konstatuara nuk përbëjnë rast për dhënie mase. Rekomandojmë që për këto raste të dilet me konkluzione dhe rekomandime, të cilat nëse
---------------------	---

	janë përgjithësuese të publikohen në faqen e APP-së dhe t'ju shërbejnë të gjithë AK.
--	--

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Nga auditimi ka rezultuar se APP, ka të miratuar Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ku në nenin 6 “Detyrimi për vetëdeklarim ose deklarimi me kërkesë të eprorit” është cilësuar: <i>“Parandalimi i llojeve të veçanta të konfliktit rast për rast të interesit do të realizohet si vijon: a-Çdo zyrtar në ushtrimin e kompetencave apo kryerjen e detyrave të tij publike, në baza të njohjes së tij në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave të tij privatë që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi”.</i> Përsa më sipër, për shkak se punonjësit e APP janë pjesë e shqyrtimit të praktikave të prokurimit publik pas lidhjes së kontratës, shqyrtimit të kërkesave dhe vendimmarrjeve për përjashtimin e OE deri në tre vjet nga procedurat e prokurimit, si edhe të shqyrtimit të Raporteve të auditimit për vlerësim të shkeljeve dhe vendimmarrjes për dhënien e masave ndaj personave përgjegjës në raport me to, duhej që për çdo rast të plotësohej paraprakisht deklarata e konfliktit të interesit.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Mbi prokurimin publik” me ndryshime dhe aktet nënligjore të fushës së prokurimit publik; Ligji nr. 9367, datë 07.04.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.
Ndikimi/efekti:	Në rast të ekzistencës së konfliktit të interesit dhe mosdeklarimit të tij paraprakisht, padrejtësisht mund të favorizohen persona të lidhur me ta. Deklarimi paraprak e vë punonjësin para përgjegjësisë në rast të mosdeklarimit të konfliktit të interesit.
Shkaku:	Mospërcaktim i këtij detyrimi në rregulloren e brendshme të APP-së, si dhe mungesa e manualit apo rregullores së procedurave të monitorimit apo shqyrtimit të raporteve audituese.
Rëndësia e shkeljes: Rekomandimi:	E ulët/E mesme/E lartë Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik, duhet të përcaktojë në Rregulloren e Brendshme të Organizimit të Punës në Agjencinë e Prokurimit Publik, Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” detyrimin për plotësimin e “Deklaratës mbi konfliktin e interesit” përpara shqyrtimit të procedurave dhe vendimmarrjes nga stafi i APP-së, si dhe të miratojë formën e deklarimit, ku të deklarohet se: a. Nëpunësi i APP në momentin e nënshkrimit të deklaratës mbi konfliktin e interesit, nuk është në dijeni të ekzistencës së konfliktit të interesave (në fakt/apo në dukje) ose faktorë të tjerë, që kufizojnë në kryerjen e detyrave të caktuara me objektivitet, vërtetësi dhe korrektësi, në respekt të zbatimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Mbi prokurimin publik” me ndryshime dhe akteve nënligjore të fushës së prokurimit publik, si dhe me ligjin nr. 9367, datë

	<p>07.04.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Organizimit të Punës së APP-së, si dhe akteve të tjera rregullatore.</p> <p>b. Në rast të shfaqjes së ndonjë konflikti të mundshëm interesi, apo çështje të tjera të kësaj natyre gjatë kryerjes së veprimtarisë, do të njoftojë menjëherë drejtuesit sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.</p>
--	--

Për sa më sipër arrijmë në konkluzionin/opinionin që: APP, në drejtim të kryerjes së hetimit administrativ (monitorimit) të procedurave të prokurimit publik pas lidhjes së kontratës përgjithësisht ka trajtuar mangësitë dhe shkeljet e evidentuara në përputhje me përcaktimet e LPP-së dhe akteve rregullative, por nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2/g/i nenin 72 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1/1 nenin 73, pika 2 nenin 66 “Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ” të LPP-së, si dhe me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” nenin 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit” germa ç, përsa i përket vendimmarrjes mbi personat përgjegjës (autoritetet kontraktore) pasi nuk ka dhënë vlerësime të drejta në raport me shkeljet e trajtuara.

Për veprimet dhe mosveprimet e cilësuara në rastet e mësipërme, mbajnë përgjegjësi:

Në cilësinë e personave që kanë qenë pjesë e vendimmarrjes:

1. E.A., me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i APP-së (Janar 2015-Maj 2017);
2. E. H., me detyrë ish Drejtoreshë e Përgjithshme e APP-së (Maj 2017-Tetor 2017);

6.3. Gjatë auditimit të raporteve të monitorimit u evidentuan raste ku sipas gjykimit të KLSH-së, ka nevojë për përmirësime të bazës ligjore si më poshtë:

Gjatë auditimit të praktikave të monitorimit, këqyrjes së dokumentacionit të tenderit, shqyrtimit të vendimeve, informacioneve përmbledhëse të autoriteteve kontraktore, procesverbaleve të NJP dhe KVO-së, ballafaqimit të gjetjeve dhe mangësive të evidentuara, në procedurat e zhvilluara nga AK dhe të trajtuara nga APP, me bazën ligjore në fuqi, konstatoam këto mangësi:

Mbi Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime.

Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit, është evidentuar fakti se autoritet kontraktore, gjatë realizimit të procedurave me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, kanë kryer procedura “fiktive”, duke ju referuar afateve kohore të kryerjes së tyre, apo plotësimit të dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, referuar dhe faktit që edhe për procedurat me “Negocim pa shpallje paraprake” në rastet e nevojave ekstreme, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 55, germës “c”, përcaktohet se: “...Në rast emergjence, autoriteti kontraktor do të marrë njëkohësisht të gjitha masat për kryerjen e procedurave normale të prokurimit”, lind nevoja e përcaktimit të kufijve minimalë të domosdoshëm për realizimin e këtyre procedurave”.

Sa më sipër rekomandojmë:

- Në nenin 43 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime, “Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave”.

Të shtohet:

a. Në procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal për dorëzimin e ofertave nga koha e marrjes së kërkesës për pjesëmarrje nga OE, të jetë 7 ditë.

b. Në procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë dhe ulët monetar, afati minimal për dorëzimin e ofertave nga koha e marrjes së kërkesës për pjesëmarrje nga OE, të jetë 5 ditë.

- Në nenin 33 “procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pika 2, germa “c”, të ndryshojë:

Është: Kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.00.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negocim me publikim nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Të bëhet: Kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.00.2006, për procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit publik” dhe afati minimal për dorëzimin e ofertave nga koha e marrjes së kërkesës për pjesëmarrje nga OE, të jetë 3 ditë.

Gjetje nga auditimi: Procesi i negocimit në LPP trajtohet vetëm për “Procedurën negocim me shpallje paraprake të njoftimit”, neni 32, pika 3, 4 dhe 5, ndërsa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 7 ku përcaktohet: “*Në rastin e procedurave me negocim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociatë në fazë të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës. Afati 10 (dhjetë) ditor i parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, nuk zbatohet në këto raste*”, trajtohet negocimi për të dy rastet e negocimit të parashikuara në nenin 32 dhe 33 të LPP-së.

Në dy nenet e mësipërme trajtohet “procedura me negocim”, ç’ka duke ju referuar titullit të procedurës, APP duhet të shprehet qartë nëse autoritetet kontraktore, kanë detyrim kryerjen e negociatave dhe mbajtjen e procesverbalit nga komisioni i vlerësimit të ofertave për të pasqyruar negociatat e kryera për të gjitha rastet e negocimit. Vetë emërtimi i këtyre dy lloj procedurave “negocim”, kërkon kryerjen e këtij procesi, por ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 33, nuk është shprehur për negocim të kontratës (referuar rasteve të përdorimit të negocimit pa shpallje paraprake të njoftimit), midis autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 33 “Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” të përcaktohet, nëse autoritetet kontraktore, duhet të negociojnë ofertat e paraqitura apo çmimin e kontratës për rastet e parashikuara në këtë nen, apo jo”.

Gjetje nga auditimi. Nga auditimi është evidentuar se, në nenin 58 pika 5 nuk është i saktë përgjithësimi i rasteve, kur ato ju përkasin një numri shumë të kufizuar të tyre. Sipas nenin 49

“Sigurimi i ofertës” pika 1 përcaktohen se: “Në procedurat e prokurimit *me vlerë më të lartë si kufiri i lartë monetar*, autoriteti kontraktor *mund t’ju* kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik”.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 58 “Njoftimi i fituesit dhe lidhja e kontratës”, pika 5 të ndryshohet:

Është: “Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar...”.

Të bëhet: “Në rastet e kontratave mbi kufijtë e lartë monetarë, kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar...”.

b. Ndryshime mbi VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjetje nga auditimi. Nga auditimi ka rezultuar se në nenin 56 “Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar”, janë përcaktuar kufizimet e titullarit të AK, të cilat duhet të vinë në harmoni me përcaktimet e bëra në:

- nenin 68 “Raporti përmbledhës” përcakton vetëm detyrimin e KVO-së për dërgim për miratim të raportit përmbledhës dhe nuk shprehet për detyrim të Titullarit të autoritetit kontraktor për miratim të tij, pranim të tij pjesërisht, kundërshtim të tij etj);

- nenin 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave” ku përcaktohet se: “*Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla*”, nuk shprehet nëse ky vendim është i ndryshueshëm nga titullari i autoritetit kontraktor apo jo.

Sa më sipër rekomandojmë:

Neni 56 “Titullari i Autoritetit Kontraktor ose zyrtari i autorizuar” paragrafi III të ndryshohet:

Është: Nuk lejohet që Titullari i Autoritetit Kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për Titullarin e Autoritetit Kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Të bëhet: Nuk lejohet që Titullari i Autoritetit Kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, *si dhe të ndryshojë apo revokojë e vendimin e KVO-së apo Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Gjetje nga auditimi. Nga auditimi është evidentuar se referimi në çmimet e tregut, si një nga mënyrat e përcaktimit të vlerës limit të kontratës, nuk është i përcaktuar qartë në nenin 59, pika 2. Në VKM, duhet të shprehet qartë nëse merret për bazë oferta më vlerën më të ulët, apo vlera mesatare e ofertave të paraqitura. Meqenëse përdorimi i mesatares neutralizon edhe ekstremitetet (+/-), si dhe për faktin që vlera limit e kontratës përbën nivelin më të lartë të lejuar, gjetje të përdorimi i mesatares së ofertave të paraqitura është më i drejtë.

Gjithashtu, për të arritur në një vlerë limit të kontratës, sa më reale gjykojmë se është e nevojshme që autoritet kontraktore të mbështeten në dy ose më shumë alternativa në përlllogaritjen e saj.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2 të ndryshohet:

Është: Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Të bëhet: Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet dy ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut, përlllogaritur si mesatare e ofertave të paraqitura; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

c) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Gjetje nga auditimi. Referuar rregullave të prokurimit publik, neni 57 “Njësia e prokurimit” njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, prandaj për këtë arsye “Njoftimi i kontratës” si një dokument i prokurimit i hartuar nga njësia e prokurimit, pavarësisht se nënshkruhet nga Titullari i autoritetit kontraktor, duhet të nënshkruhet edhe nga njësia e prokurimit.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” pika 3.

Është: Pas hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia dhe nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, njësia e prokurimit i dërgon ato për publikim në përputhje me nenet 38 e 39 të LPP.

Të bëhet: Pas hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia dhe nënshkrimit të njoftimit të kontratës prej saj dhe nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, njësia e prokurimit i dërgon ato për publikim në përputhje me nenet 38 e 39 të LPP.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar se, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, në nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës” pikat 5 dhe 6 është përcaktuar:

“5. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.

6. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

Në këtë pikë të nenit nuk janë përcaktuar qartë dy momente:

Së pari, nuk është përcaktuar se sa është ndryshimi i dukshëm (+/-) në përqindje kundrejt çmimit të kontratës.

Së dyti, nuk është përcaktuar qartë se cili është momenti kundrejt të cilit duhet të krahasohet çmimi i kontratës për të përlogaritur këtë diferencë. Çmimi i kontratës kundrejt çmimit sipas Reuters në momentin e shitjes (faturimit të mallit), apo çmimi i kontratës kundrejt çmimit sipas Reuters në momentin e zhdoganimit të mallit sipas SAD (Dokumenti i vetëm administrative).

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës” pika 5 dhe 6 të ndryshohet:

Është:

Pika 5 “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

Pika 6 “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

Të bëhet:

Pika 5 “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon X % në raport me çmimin e kontratës, me kërkesë me shkrim të palëve në momentin e shitjes së mallit objekt kontrate autoriteteve kontraktore, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

Pika 6 “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në momentin e shitjes së mallit objekt kontrate autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

6.4. Përjashtimet e operatorëve ekonomikë nga procedurat e prokurimit publik.

Tabela nr. 13-Të dhënat mbi procesin e përjashtimit të OE nga procedurat e prokurimit

Viti	Vendime Përjashtimi	Vendime Mospërjashtimi	Çështje të pezulluara	Çështje në proces	Të pa plota (dokumentacioni)	Totali
2015	6	5	4	1	15	31
2016	6	9	3	7	15	40
2017	6	4	-	15	15	40

Burimi i informacionit: APP

Punoi: KLSH

Në përfundim arrijmë në konkluzionin/opinionin që: Informacioni i paraqitur mbi çështjen dhe objektin e auditimit është në çdo aspekt material i vërtetë dhe i drejtë, si dhe në përputhje me kriteret e vlerësimit ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me përjashtim të dy rasteve, vendimi nr. 13, datë 08.02.2016 dhe vendimi nr. 39, datë 07.04.2017, ku APP ka vepruar në kundërshtim me nenin 13, pika 3/ç të LPP-së.

7. Mbi sigurimin e transparencës, bashkëpunimit me të tretët, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik; me entet e tjera për zbatimin e standardeve kombëtare në

përgatitjen e specifikimeve teknike nga autoritet kontraktore; me organet e auditimit publik, si KLSH, strukturat e Auditimit të Brendshëm, Inspektimin Financiar mbi shqyrtimin e raporteve audituese të paraqitura prej tyre.

7.1. Programi i transparencës së Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).

I. Për të siguruar transparencën e veprimtarisë, APP ka vepruar në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI), duke hartuar e zbatuar programin përkatës. Në këtë program është përcaktuar korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të këtij ligji, duke ndërtuar e rritur gjithnjë e më tepër trasparencën institucionale dhe është përditësuar herë pas here, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Për publikimin e informacionit, me qëllim njohjen e veprimtarisë së Agjencisë të Prokurimit Publik, është përdorur faqja zyrtare [ëëë.app.gov.al](http://ee.app.gov.al) si dhe afishimi i programit në mjediset e pritjes së publikut në institucion. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afate kohor dhe mënyrën për bërjen publike të tij, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në programin e transparencës është evidentuar skema e publikimit, ku pasqyrohen *menu-të*, ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare të internetit. Çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë, i përditësuar në formë dhe përmbajtje. Faqja zyrtare e AP-së është e ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave etj.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Një mangësi e konstatuar, është se APP nuk publikon në faqen e internetit arsyetimet dhe vendimet, në kuadrin e shqyrtimit të raporteve të institucioneve audituese, apo hetimit administrativ që kryen vetë institucioni, dhënien e masave administrative, gjoha sipas nenit 72/1 të LPP, propozime për titullarët e AK-ve për masa disiplinore, si dhe vendimet për përjashtimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik nga procedurat e prokurimit.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” nenin 7, ku përcaktohet: “(k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh; (l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik”. - Ligji nr. ligjit 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manuali “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku përcaktohet: “Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Komunikimi i jashtëm me njësi të tjera, ose me palë të treta, kërkon një balancim të interesave; nga njëra anë, ai bëhet për të plotësuar disa nevoja dhe për t’iu përgjigjur disa qëndrimeve të publikut; por nga ana tjetër, ai duhet të jetë në përputhje me standardet dhe/ose ligjet që rregullojnë aksesin e lirë dhe mbrojtjen e informacionit”.
Ndikimi/efekti:	Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për

<p>Shkaku: Rëndësia e shkeljes: Rekomandimi:</p>	<p>përdoruesin. Kjo i shërben transparencës, duke zgjeruar lirinë e aksesit në dokumentacionin administrativ, lirinë e informacionit, garancinë e një drejtësie administrative dhe motivimin e vendimeve të marra. Gjithashtu, kjo i shërben përgjegjshmërisë, që nënkupton përgjegjësinë e vendimmarrësve, kontrollat mbi administratën, etj. Mosveprim i Titullarëve të APP-së. E ulët/E mesme/E lartë Nga Titullari i APP-së të merren masa që në programet e transparencës të përfshihet edhe publikimi i vendimeve të APP për shqyrtimin e raporteve të institucioneve audituese apo hetimit administrativ, të arsyetimit të masave administrative e propozimeve për masa disiplinore ndaj personave përgjegjës, dhe operatorëve që përjashtohen përkohësisht nga procedurat e prokurimit.</p>
---	--

7.2. Bashkëpunimi me të tretët për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik.

APP bashkëpunon me të tretët për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit, dhe konkretisht për të nxitur përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare publik siç përcaktohet në nenin 13, germa “f” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik i ndryshuar, ku shprehet:

f)nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve;

Gjatë periudhës nga viti 2015-gusht 2017, APP ka bashkëpunuar:

- Me shkollën Shqiptare të Administratës Publike;
- Me Komisionin e Prokurimit Publik;
- Në kuadër të implementimit të planit të masave për Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike, Strategjinë Kombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe Strategjinë ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet përgjegjëse për koordinimin e tyre dhe konkretisht, Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike;
- Me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
- APP ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore, Delegacioni i Bashkimit European në Tiranë apo OECD/SIGMA. APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me Bankën Botërore në kuadër të procesit të vlerësimit të sistemit të prokurimit publik dhe implementimin e kontratave të ndërmarrë prej tyre gjatë vitit 2015-2016.
- APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me Delegacionin e BE-së në Tiranë dhe SIGMA për hartimin e ndryshimeve të ligjit të prokurimit publik me qëllim riorganizimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe garantimin e pavarësisë së tij nga Kryeministri. Gjatë vitit 2017, APP ka bashkëpunuar me SIGMA edhe për përgatitjen e një raporti mbi shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimit, koncesioneve, PPP-ve etj me direktivat përkatëse të Bashkimit European.

Gjetje nga auditimi:

<p>Situata:</p>	<p>Nga auditimi ka rezultuar se midis APP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, pavarësisht korrespondencës nuk ka patur rezultate në minimizimin e rasteve, kur operatorë ekonomikë,</p>
------------------------	--

<p>Kriteri:</p> <p>Ndikimi/efekti:</p> <p>Shkaku:</p> <p>Rëndësia e shkeljes:</p> <p>Rekomandimi:</p>	<p>për plotësimin e kriterëve të cilësisë paraqesin certifikata të lëshuara nga trupa të pa akredituara nga institucione të specializuara kombëtare ose ndërkombëtare. Nga ana tjetër, për shkak të kërkesës së lartë nga subjektet që kërkojnë të marrin pjesë në tender, trupat certifikuese jo vetëm që ofrojnë shërbime të pa akredituara, por në shumë raste nuk ndjekin procedurat korrekte të certifikimit. Në këto kushte, kriteri i certifikimit të subjekteve si garanci për shërbimin që ofrohet zhvlerësohet dhe cilësia e shërbimit nuk është ajo e përcaktuar në standardin, të cilit i është referuar AK.</p> <p>Ligji nr. 9634, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime nenin 13, germa “f” ku përcaktohet: “<i>APP nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve</i>”.</p> <p>Në këto kushte, kriteri i certifikimit të subjekteve si garanci për shërbimin që ofrohet zhvlerësohet dhe cilësia e shërbimit nuk është ajo e përcaktuar në standardin, të cilit i është referuar AK për certifikim. Paraqitja e dokumenteve të tilla, ndikon në cilësinë e punëve, mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga OE.</p> <p>Mosbashkëpunim në nivelet e duhura më DPS.</p> <p>E ulët/E mesme/E lartë</p> <p>APP të rrisë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, duke reklamuar pranë saj, të gjitha rastet e autoriteteve të palicencuara, që lëshojnë certifikata të cilësisë sipas kërkesave nga operatorët ekonomikë, si dhe ti bëjnë ato publike, në faqen e eeb.app.gov.al.</p>
--	---

7.3. Bashkëpunimi me organet e auditimit publik, shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve audituese, KLSH, strukturat e auditimit të brendshëm, Inspektimin Financiar mbi shqyrtimin e çështjeve të paraqitura prej tyre.

Për periudhën objekt auditimi, APP ka shqyrtuar raportet përfundimtare të auditimit, për pjesën ku trajtohet zbatimi i ligjit e rregullave të prokurimit publik në tenderat e zhvilluar, si vijon:

Vitet	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Audite të Brendshme të institucioneve	Komis. Prokur. Publik	Drejt. Inspekt. Financiar	Prokuroria Fier	Gjithsej
2015	20	11	20	9	1		61
2016	30	5	9	4	1	1	50
8 muj 2017	11	9	5				25

Janë audituar dosjet e vendimmarrjes nga APP, për procedurat e prokurimit të audituara nga institucionet e auditimit, për këto Autoritete Kontraktore (AK), bazuar në nenin 13, germa “g” dhe neni 72 të LPP, ku shprehet:

g) verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrtton rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, si dhe monitoron

mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.

dhe

Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kur përbën kundërvajtje administrative dënohet me gjobë. 1/1 Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlllogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. 2. Në të gjitha rastet e mësipërme, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë, dhe në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj tyre.

Tabela nr. 14-Dosjet e audituara nga grupi i punës

Nr	Institucioni auditues	Subjekti i Audituar
I Viti 2015		
1.	KLSH	Vendimi i APP nr.4, datë 15.01.2015 me objekt dhënie mase në Bashkinë Korçë
2.	Auditi MSH	Vendimi i APP nr.11, datë 7.02.2015 me objekt dhënie mase në Spitalin Rajonal Fier
3.	KPP	Vendimi i APP nr.13, datë 19.02.2015 me objekt dhënie mase në KESH sha
4.	KLSH	Vendimi i APP nr.21, datë 18.03.2015 me objekt dhënie mase në UK Korçë
5.	KLSH	Vendimi i APP nr.25, datë 1.04.2015 me objekt dhënie masa në Bashkinë Himarë
6.	KLSH	Vendimi i APP nr.82, datë 24.07.2015 me objekt dhënie mase në AKTurizmi
7.	KLSH	Vendimi i APP nr.4, datë 15.01.2015 me objekt dhënie mase në Bashkinë Korçë
8.	FSDKSH	Vendimi i APP nr.88, datë 10.08.2015 me objekt dhënie mase në SU "Sh.Ndroqi" Tiranë
9.	KLSH	Vendimi i APP nr.89, datë 14.08.2015 me objekt dhënie mase në Bashkinë Fier
10.	KLSH	Vendimi i APP nr.97, datë 2.10.2015 me objekt dhënie mase në Bashkinë Pogradec
II 2016		
1.	KLSH	Vendimi i APP nr.4, datë 7.01.2016 me objekt dhënie mase në Min. Arsimit dhe Sportit
2.	KLSH	Vendimi i APP nr.18, datë 7.03.2016 me objekt dhënie mase në Bashkinë Kavajë
3.	KLSH	Vendimi i APP nr.21, datë 18.03.2016 me objekt dhënie mase në Bashkinë Tiranë
4.	KLSH	Vendimi i APP nr.59, datë 24.06.2016 me objekt dhënie mase në Autoritetin Rrugor Shqip.
5.	KLSH	Vendimi i APP nr.76, datë 22.09.2016 me objekt dhënie mase në Bashkinë Lezhë
6.	KLSH	Vendimi i APP nr.90, datë 17.10.2016 me objekt dhënie mase në Bashkinë Pogradec
III 2017		
1.	Aud.Brend	Vendimi i APP nr.8, datë 27.01.2017 me objekt dhënie mase në Min. Zhvillimit Urban
2.	KLSH	Vendimi i APP nr.73, datë 31.08.2017 me objekt dhënie mase në Bashkinë Sarandë

Në raportet e audituara, shkeljet kryesore të evidentuara më shpesh, konsistojnë në:

- Mungesën e argumentimit dhe dokumentimit të përlllogaritjes së fondit limit të objekteve që prokurohen, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit 9643/2016 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Kjo problematikë është konstatuar në shumë procedura prokurimi sidomos për prokurimin e punëve publike, veçanërisht në rastet kur preventivi i objektit të prokurimit është hartuar nga një subjekt i licencuar. Vërehet se, nuk dokumentohen referencat e çmimeve njësi të përdorura dhe/ose nuk hartohen analiza çmimi për zërat e punimeve, që nuk përfshihen në manualët përkatëse të çmimeve zyrtare.
- Shkelje të procedurave që lidhen me argumentimin e kritereve të kualifikimit, mungesa të raporteve përmbledhëse të procedurave të prokurimit apo mos nënshkrimi i tyre nga anëtarë të KVO, mungesë e deklaratave mbi konfliktin e interesit etj.
- Në shumë raste janë konstatuar shkelje të nenit 23 të ligjit, sepse autoritetet kontraktore nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit për hartimin e specifikimeve teknike.
- Shkelja më e shpeshtë i përket moszbatimit të kërkesave të nenit 53 të LPP, vlerësimin e pranimit e ofertave në përputhje ose jo me kërkesat e autoriteti kontraktor parashtruar në DT, e kombinuar me nenin 46 të ligjit. Shkelje të kryera nga komisionet, lidhur me vlerësimin e

ofertave gjatë kualifikimit e klasifikimit të operatorëve ekonomik, të cilat janë të dënueshme me masa administrative “gjobë”, që varion nga 50.000 deri 1.000.000 lekë. Siç vihet re, kufiri maksimal i gjobës është më i larti që referon ligji, duke kuptuar se ligjvënësi ka synuar që të dekurajojë zyrtarët që të shkelin këtë nen.

- Në një numër të konsiderueshëm të konstatimeve në raportet e auditimit, konstatohen shkelje të nenit 56 të ligjit, që lidhet me trajtimin e ofertave anomalisht të ulëta.
- Një prej shkeljeve të konstatuara është dhe ajo lidhur me moszbatimin e kërkesave të nenit 63 të LPP, ku shprehet zbatimi i të drejtës së ankimit nga OE tek AK dhe KPP, procedurat që duhen zbatuar kur shkelen të drejtat e operatorëve ekonomik.

Në kuadër të veprimtarisë së vet, APP ka marrë në shqyrtim raportet e dërguara nga organet audituese, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) Drejtoria e Kontrollit Spitalor, Drejtoria e Inspektimit Financiar, Auditet e Brendshme të institucioneve. Ka bashkëpunuar me Komisionit të Prokurimit Publik, për shqyrtimin e rekomandimeve të këtij të fundit, lidhur me shkelje të dispozitave ligjore të evidentuara nga ky institucion, gjatë procesit të rishikimit administrativ.

Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi, janë konstatuar probleme në kundërshtim me bazën ligjore, të cilët janë shprehur gjerësisht në Raportet Përfundimtare të Auditimit të institucioneve audituese dhe janë analizuar e marrë vendime nga APP.

Nga shqyrtimi i konkluzioneve të APP, lidhur me vlerësimin e konstatimeve të institucioneve të auditimit, të kundërshtimeve të autoriteteve kontraktore mbi konstatimet e auditit dhe vendimet ndaj zyrtarëve që kanë kryer shkelje në procedurat e prokurimit, **arrijmë në konkluzionin që:**

1. Nga auditimi i raporteve të organeve audituese, për pjesën e prokurimeve publike, ka rezultuar se niveli i masave administrative të vendosura nga APP, për zyrtarët që janë marrë me prokurimet dhe kanë shkelur procedurat, në shumë raste është minimal (rekomandim mase disiplinore tek titullari i AK apo tërheqje vëmendje e këshillim nga APP).

Ligji për prokurimin publik parashikon një numër të madh kundërvajtjesh administrative, të cilat dënohen me masë administrative “gjobë” ose rekomandime titullarit të AK për masa disiplinore, të cilat sipas rastit është Agjencia e Prokurimit Publik që i merr vendimet. Kallëzimet penale trajtohen ekskluzivisht nga prokuroria e rrethit gjyqësor përkatës, si në çdo rast tjetër të ndjekjeve penale, duke pas parasysh se, procedimi administrativ mund të fillojë edhe me nismën e Agjencisë së Prokurimit Publik, pas një hetimi administrativ të plotë nga kjo e fundit.

Praktika ka treguar se, shqyrtimi i procedurave, mbas marrjes së vendimit nga KVO, kalon në organet ligj zbatuese (KPP dhe APP), të cilët nuk mund të shërbejnë si “filtra” nëqoftëse tolerojnë shkeljet, duke favorizuar kulturën e pandëshkueshmërisë.

Pas konstatimit të shkeljeve nga institucionet e auditit si, KLSH, KPP, Inspektimi financiar apo auditet e brendshme dhe kërkesës së tyre për penalizim, i takon Agjencisë së Prokurimit Publik, t’i vlerësojë dhe në përputhje me bazën ligjore përkatëse, të marrë masa administrative, ose të rekomandojë për titullarin e AK marrjen e masave disiplinore, ndaj personave që kanë kryer shkelje të procedurave në prokurimet publike.

2. Për periudhën që auditohet, vihet re se masat ndaj zyrtarëve që kanë kryer shkelje të procedurave të prokurimit është në rritje. Sipas evidencave të APP, mbështetur në shkeljet e konstatuara në raportet e organeve audituese janë dhënë masa “gjobë” me vlera të niveleve të ndryshme, apo janë rekomanduar dhe masa disiplinore, si më poshtë në tabelë:

Tabela nr. 15-Masat e dhëna

Masat	Periudha		
	2015	2016	8 mujori 2017
Masa administrative (gjobë)	86	159	143
Masa disiplinore (nr.subjekte)	49	35	19

Numri i madh i shkeljeve të konstatuara, përsëritja e tyre në disa procedura procedura prokurimi, siç janë trajtuar hollësisht në Projekt raportin e Auditimit, tregon se ka vend për më shumë masa administrative ndaj personave që i kanë kryer këto shkelje.

Shpesh në materialet e dosjeve të audituara, konstatohet se, masa administrative “gjobe” e rekomanduar nga organi auditues, nuk është zbatuar, duke i rekomanduar titullarit masë disiplinore, ose APP i “këshillon” apo “tërheq vëmendjen”, zyrtarëve të prokurimit, për mos përsëritjen e veprimeve në kundërshtim me bazën ligjore e rregullat e prokurimit publik, në procedurat e periudhës në vazhdim.

Për shqyrtimin e rekomandimeve të organeve audituese lidhur me procedurat e prokurimit, APP është mbështetur në konstatimet e paraqitura në materialin auditues, përgatitur nga audituesit e KLSH-së, audituesve të brendshëm i institucioneve apo ai financiar, në propozimet që ato kanë dhënë për personat përgjegjës në prokurimet e audituara, pasi ka vlerësuar kundërshtimet e Autoriteteve Kontraktore, të ballafaquara me bazën ligjore e nënligjore të prokurimeve publike. Për konstatimet e paraqitura nga organet e auditit në Raportet Përfundimtare, APP ka bërë arsyetimet e veta duke vlerësuar kundërshtimet e autoriteteve kontraktore dhe interpretimin nga ana ligjore të tyre. Por, konstatohet jo rallë, edhe pse konstatimet e auditit vlerësohen të mbështetura ligjërisht, edhe pse rekomandimet nga institucionet audituese janë për masa administrative sipas bazës ligjore, nenit 72/1 të LPP, APP kalon tek rekomandimet për masa disiplinore ndaj zyrtarëve që kanë kryer shkelje në procedurat e prokurimit.

Nga shqyrtimi i raporteve të auditit për procedurat e prokurimit, konstatohet se APP nuk ka vepruar me forcën e duhur të ligjit, për të parandaluar dhe ndëshkuar vlerësimet me dy standarde nga KVO, në procesin e kualifikimit të operatorëve pjesëmarrës në konkurrim. Vlerësimi me dy standarde nga KVO, është konstatuar në procedura të ndryshme por dhe brenda një prokurimi. Ndërsa qëndrimi dhe vendimi i APP-së ndaj këtij fenomeni ka qenë: “Në mbështetje të neneve 13, pika 2/i të LPP, *t’i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore, si persona përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me nenin 53 të LPP, në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës dhe sipas konstatimeve në këtë vendim*”.

Shpesh në materialet e dosjeve të audituara, konstatohet se, masa administrative “gjobe” e rekomanduar nga organi auditues, nuk është zbatuar nga APP, duke i rekomanduar titullarit masë disiplinore, këshillim apo edhe tërheqje vëmendje, për mos përsëritjen e veprimeve në kundërshtim me bazën ligjore e rregullat e prokurimit publik, në procedurat e periudhës në vazhdim.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Konkretisht, me vendimin nr. 4, datë 7.01.2016, lidhur me shqyrtimin e Raportit Përfundimtar të KLSH (pjesa e prokurimeve publike), në autoritetin kontraktor ish Ministria e Arsimit dhe Sportit (sot Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), APP ka analizuar shkeljet në dy procedura prokurimi dhe pasi ka vlerësuar të drejta shumicën e konstatimeve të KLSH-së, për masat është shprehur: <u>APP i tërheq vëmendjen</u> grupit të punës për shqyrtimin e projektit e përllogaritjen e
-----------------	---

Kriteri:	fondit limit dhe anëtarëve të KVO, për parregullsitë e vërejtura, sipas konstatimeve në këtë vendim, që të jenë të kujdesshëm në të ardhmen gjatë fazës së përllogaritjes së fondit limit dhe vlerësimit të ofertave. Ligji nr. 9634, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime neni 66 dhe 72, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 79.
Ndikimi/efekti:	Mos ndëshkueshmëria rrit rastet e shkeljeve, ndikon në zhvillimin e procedurave jo në përputhje me ligjin si dhe në realizimin e punëve publike, shërbimeve dhe mallrave ndaj AK si në cilësi ashtu edhe në vlerë, duke rritur kostot.
Shkaku:	Abuzimi me të drejtën diskreacionale që ligji i njeh APP-së në vlerësimin e procedurave në fushën e prokurimeve, koncesioneve, ankandeve etj.
Rëndësia e shkeljes: Rekomandimi:	E ulët/ E mesme /E lartë Për shkelje të natyrës përcaktuese për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit, në zbatimin rigoroz të procedurave kualifikuese apo edhe në zbatimin e afateve të ankimit nga operatorët ekonomik e shqyrtimin profesional e me paanshmëri të tyre, minimalisht ndaj personave përgjegjës, APP duhet të vendos masa administrative (vendosja e gjobave), me qëllimin e mirë, që në vazhdim të dekurajojë veprimet joligjore të zyrtarëve të prokurimit. Në rastet e shkeljeve flagrante të ligjit e akteve nënligjore të prokurimit, APP të ushtrojë të drejtën për t’u drejtuar organeve të prokurorisë e gjykatës.

3. Një problem tjetër lidhur me vendimet e APP është se, praktika e ndjekur rekomandim i masave disiplinore tek titullari i autoritetit kontraktor, dhe mosnjohja me “fatin” e zbatimit të tyre, nuk është efektive.

Gjetje nga auditimi:

Situata:	Nga auditimi ka rezultuar se APP nuk administron asnjë të dhënë mbi zbatimin e penalteteve dhe masave disiplinore nga AK. Për këtë arsye APP nuk mund të vlerësojë nivelin e zbatueshmërisë së tyre, apo efektet e këtyre masave apo gjobave të vendosura.
Kriteri:	Nuk ka kriter ligjor të përcaktuar, pasi në LPP, në nenin 72, pika 4 ka përcaktuar vetëm autoritetin përgjegjës për zbatimin e tyre, si dhe nuk ka përcaktuar mënyrën dhe formën e raportimit të zbatimit të tyre pranë strukturës që i ka propozuar ato, APP-së.
Ndikimi/efekti:	APP nuk ka asnjë mundësi të vlerësojë efektivitetin e punës së saj, për vlerësimin e zbatimit të ligjit nga AK, si dhe sa janë marrë në konsideratë nga AK, shkeljet e ligjit të evidentuara nga APP.
Shkaku:	Nuk ekziston një detyrim ligjor mbi AK, për raportimin e zbatimit të gjobave dhe masave disiplinore të propozuara nga APP.
Rëndësia e shkeljes: Rekomandime: (përmirësim ligjor)	Ulët/ mesëm /lartë Të bëhet ndryshimi ligjor i mëposhtëm: Në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative”, pika 4 të LPP-së dhe

	<p>nenin 79 “Sanksionet administrative” pika 4, të VKM-së, të ndryshohet:</p> <p><u>Është:</u> Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.</p> <p><u>Të bëhet:</u> Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor. <i>Autoriteti Kontraktor është i detyruar që brenda 30 ditëve të dërgojë në APP informacion mbi masat e marra për vendosjen e gjobave dhe masave disiplinore të ndërmarra nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, sipas propozimeve të APP-së, për personat përgjegjës.</i></p>
--	--

SQARIM MBI OBSERVACIONET:

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e subjektit të audituar të paraqitura me shkresën nr. 14144/12, datë 20.12.2017 dhe të protokolluara në KLSH me nr. 860/5, datë 20.12.2017, pas njohjes së subjektit me Projektraportit të Auditimit, **sqarojmë sa më poshtë vijon:**

- Përsa është observuar pjesërisht në lidhje me masën organizative mbi konfliktin e interesit, observacioni i subjektit është marrë në konsideratë, pasi janë paraqitur dokumente shtesë. Ndryshimi i rekomandimit është reflektuar në RPA.

-Përsa është observuar në lidhje me emërimin e nëpunësit zbatues, observacioni i subjektit në lidhje me afatet qëndron, pasi janë paraqitur argumente shtesë, që vërtetojnë qëndrimin e tij. Në përmbajtje konstatimi i KLSH qëndron dhe është marrë në konsideratë nga APP, e cila me shkresën nr. 14964, datë 14.12.2017 i ka kërkuar Kryeministrisë, ndryshimin e strukturës organizative dhe reflektimin e ndryshimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ligjin nr. 110/2015, sipas të cilit kërkohet që nëpunësi zbatues të jetë me profesion ekonomist. Ndryshimi është reflektuar në RPA.

- Përsa i përket kontabilizimit të llogarisë 7602 “Financim i pritshëm nga buxheti” observacioni juaj pranohet pjesërisht dhe është reflektuar në RPA.

- Përsa i përket përlllogaritjes së amortizimit për pajisjet IT, për të cilat nuk është përlllogaritur amortizim sqarojmë se në kontabilitet duhet të pasqyrohen me vlerën e mbetur, pra duke përlllogaritur çdo vit amortizimin sipas normave të përcaktuara. Argumentimi i APP-së, se pajisjet e mësipërme nuk janë nxjerrë jashtë përdorimi me komision të posaçëm dhe për këtë arsye figurojnë gjendje në kontabilitet dhe pasqyrohen me vlerën e tyre fillestare nuk qëndron, pasi AQT pasqyrohen në kontabilitet me vlerën e mbetur pasi është përlllogaritur amortizimi, i cili pasqyrohet në llogarinë 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”. Observacioni nuk pranohet.

- Përsa është observuar në lidhje me hartimin dhe propozimin te nëpunësi autorizues planin strategjik, në përmbajtje konstatimi i KLSH qëndron dhe është marrë në konsideratë nga APP i cili është shprehur se do të marrë parasysh rekomandimin për përgatitjen e një plani masash të përbashkët për hartimin e planit strategjik.

- Përsa është observuar në lidhje me mjedisin e kontrollit, për politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, observacioni i subjektit nuk merret në konsideratë. (Trajtuar më hollësisht në PRA)

Përsa është observuar në lidhje me aktivitetet e kontrollit, në përmbajtje konstatimi i KLSH qëndron dhe është marrë në konsideratë nga APP, e cila është duke punuar për hartimin e një

rregulloreje të detajuar lidhur me zhvillimin e procedurave të monitorimit, shqyrtimit të raporteve audituese, si dhe zhvillimit të procedurave për përjashtimin e Operatorëve Ekonomikë.

-Përsa është observuar në lidhje me mendimet e dhëna nga APP institucioneve të ndryshme, observacioni i subjektit nuk merret në konsideratë. (Trajtuar më hollësisht në PRA)

- Përsa i përket observacioneve mbi monitorimin e procedurave, observacioni juaj nuk pranohet pasi argumentet nuk janë të bazuara. Ne trajtimin e bërë në Projektraportin e auditimit janë paqyruar të gjitha observacionet e APP-së në lidhje me praktikat e veçanta si dhe janë marrë në konsideratë të gjitha observacionet mbi aktkonstatimin nr. 2, datë ... të cilat kanë qenë të argumentuara dhe mbështetura ligjërisht.

- Përsa ju përket konstatimeve mbi mënyrën e procedimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes së APP-së mbi personat përgjegjës, KLSH i ka trajtuar, sqaruar dhe argumentuar ligjësisht në Projektraportin e Auditimit. Nga APP nuk janë paraqitur argumente shtesë.

- U shqyrtuan observimet e subjektit APP për Projektraportin e Auditimit. Lidhur me masat e rekomanduara nga APP, për shkeljet e konstatuara nga institucionet audituese, KLSH nuk është shprehur se veprimet janë në kundërshtim me bazën ligjore, por se masat e rekomanduara nuk janë në raport me shkeljet e konstatuara nga auditimi.

- Në observacion shpreheni se, APP nuk ka konkluduar specifikisht për masën “këshillim”. Edhe audituesit e KLSH-së, nuk janë shprehur se këshillimet apo terhejet e vëmendjes janë masa të dhëna në vendimet e APP (pasi nuk parashikohen në bazën ligjore), por gjatë argumentimit të shkeljeve të konstatuara nga auditimi, është shprehur për këshillim apo tërheqje vëmendje ndaj personave që kanë kryer shkelje.

APP, për të argumentuar qëndrimin për mosdhënien e masave administrative, jep shifra të hapjes së çështjeve gjyqësore nga zyrtarët e prokurimit, që ankimojnë masat, sidomos ato administrative. Kjo nuk përbën argument për mosdhënien e masave, pasi ankimi është një e drejtë e personave që mendojnë se janë cënuar nga masat e rekomanduara. APP ka për detyrë të mbrojë argumentimet për masat apo rekomandimet e dhëna.

Observohet nga APP se, masat disiplinore nuk janë penalizime “të lehta”, janë më të efektshme mbi personin që kryen shkelje të rregullave e procedurave të prokurimit. Këtij observimi, mund ti përgjigjemi me pyetje; sa dhe çfarë masash disiplinore janë dhënë nga Titullarët e autoriteteve kontraktore gjatë periudhës së auditimit, sa prej personave ndaj të cilëve është rekomanduar masa disiplinore, janë ankimuar në Gjykatën Administrative? Titullarët e institucioneve, të cilëve APP u rekomandon marrjen e masave disiplinore, shpesh edhe ato janë në grupin e zyrtarëve që kanë shkelur rregullat e prokurimit publik, prandaj edhe për këtë arsye, shkalla e interesimit për dhënien e masave disiplinore, nuk është në nivelin e duhur. APP nuk ka statistika për llojet e masave disiplinore që kanë dhënë titullarët e autoriteteve kontraktore, për nivelin e zbatimit të tyre e aq më tepër për efektet e tyre në uljen e shkeljeve në procedurat e prokurimit etj. Në Projektraportin e Auditimit, kemi dhënë shembuj që, të njëjtët zyrtar prokurimesh, për të cilët është rekomanduar masë disiplinore, kanë vazhduar të kryejnë shkelje në procedurat në vazhdim të periudhës (biles shkelje ndoshta edhe më të rënda se të parat).

Audituesit e KLSH-së, duke kërkuar dhënien masave nga APP apo rekomandim për masa disiplinore, në përputhje me shkeljet e konstatuara dhe pasojat që ato kanë patur, nuk përjashtojnë rolin politikë-bërës e rregullator në sistemin e prokurimit, përkundrazi.

IV/2 Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

a. Mbi Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit, është evidentuar fakti se autoritet kontraktore, gjatë realizimit të procedurave me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, kanë kryer procedura “fiktive”, duke ju referuar afateve kohore të kryerjes së tyre, apo plotësimit të dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, referuar dhe faktit që edhe për procedurat me “Negocim pa shpallje paraprake” në rastet e nevojave ekstreme, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 55, germës “c”, përcaktohet se: “...Në rast emergjence, autoriteti kontraktor do të marrë njëkohësisht të gjitha masat për kryerjen e procedurave normale të prokurimit”, lind nevoja e përcaktimit të kufijve minimalë të domosdoshëm për realizimin e këtyre procedurave”.

Sa më sipër rekomandojmë:

1.1. Në nenin 43 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime, “Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave”.

Të shtohet:

a. Në procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati minimal për dorëzimin e ofertave nga koha e marrjes së kërkesës për pjesëmarrje nga OE, të jetë 7 ditë.

b. Në procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë dhe ulët monetar, afati minimal për dorëzimin e ofertave nga koha e marrjes së kërkesës për pjesëmarrje nga OE, të jetë 5 ditë.

1.2. Në nenin 33 “procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pika 2, germa “c”, të ndryshojë:

Është: Kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.00.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negocim me publikim nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Të bëhet: Kur për arsye të nevojës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.00.2006, për procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit publik dhe afati minimal për dorëzimin e ofertave nga koha e marrjes së kërkesës për pjesëmarrje nga OE, të jetë 3 ditë.

2. Gjetje nga auditimi: Procesi i negocimit në LPP trajtohet vetëm për “Procedurën negocim me shpallje paraprake të njoftimit”, neni 32, pika 3, 4 dhe 5, ndërsa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 7 ku përcaktohet: “Në rastin e procedurave me negocim, me ose **pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës**, në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociata në faza të ndryshme me secilin

nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës. Afati 10 (dhjetë) ditor i parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, nuk zbatohet në këto raste”, trajtohet negociimi për të dy rastet e negociimit të parashikuara në nenin 32 dhe 33 të LPP-së.

Në dy nenet e mësipërme trajtohet “procedura me negociim”, ç’ka duke ju referuar titullit të procedurës, APP duhet të shprehet qartë nëse autoritetet kontraktore, kanë detyrim kryerjen e negociatave dhe mbajtjen e procesverbalit nga komisioni i vlerësimit të ofertave për të pasqyruar negociatat e kryera për të gjitha rastet e negociimit. Vetë emërtimi i këtyre dy lloj procedurave “negocim”, kërkon kryerjen e këtij procesi, por ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 33, nuk është shprehur për negociim të kontratës (referuar rasteve të përdorimit të negociimit pa shpallje paraprake të njoftimit), midis autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Sa më sipër rekomandojmë:

2.1. Në nenin 33 “Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” të përcaktohet, nëse autoritetet kontraktore, duhet të negociojnë ofertat e paraqitura apo çmimin e kontratës për rastet e parashikuara në këtë nen, apo jo”.

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi është evidentuar që APP, nuk ka asnjë informacion mbi zbatimin e masave administrative, apo disiplinore të vendosura dhe propozuara prej saj. Administrimi i të dhënave mbi nivelin e zbatueshmërisë së vendimeve të saj është një indikator i matshëm rreth efektivitetit të vendimmarrjeve.

Sa më sipër rekomandojmë:

3.1. Në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative”, pika 4 të LPP-së dhe nenin 79 “Sanksionet administrative” pika 4, të VKM-së, të ndryshohet:

Është: Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

Të bëhet: Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor. *Autoriteti Kontraktor është i detyruar që brenda 30 ditëve të dërgojë në APP informacion mbi zbatimin e penalteteve të vendosura nga APP dhe masave disiplinore të ndërmarra nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, për personat përgjegjës.*

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi është evidentuar se, në nenin 49 pika 1, janë përjashtuar nga kërkesa për paraqitjen e sigurimit të ofertës, procedurat e prokurimit me vlera nën kufirin e lartë monetare, gjë e cila nën gjykimin e KLSH-së, ndikon në tërheqjen e ofertuesve pas klasifikimit të ofertave, duke favorizuar ofertues të caktuar e duke çuar deri në dështimin e procedurave.

Sa më sipër rekomandojmë:

4.1. Në nenin 49 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 të ndryshohet:

Ishte: Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik

Bëhet: Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor duhet t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik.

b. Ndryshime mbi VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi ka rezultuar se në nenin 56 “Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar”, janë përcaktuar kufizimet e titullarit të AK, të cilat duhet të vinë në harmoni me përcaktimet e bëra në:

- nenin 68 “Raporti përmbledhës” përcakton vetëm detyrimin e KVO-së për dërgim për miratim të raportit përmbledhës dhe nuk shprehet për detyrim të Titullarit të autoritetit kontraktor për praninë të tij tërësisht, pjesërisht, apo kundërshtim);

- nenin 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave” ku përcaktohet se: “Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla”, nuk shprehet nëse ky vendim është i ndryshueshëm nga titullari i autoritetit kontraktor apo jo.

Sa më sipër rekomandojmë:

Neni 56 “Titullari i Autoritetit Kontraktor ose zyrtari i autorizuar” paragrafi III të ndryshohet:

Është: Nuk lejohet që Titullari i Autoritetit Kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për Titullarin e Autoritetit Kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Të bëhet: Nuk lejohet që Titullari i Autoritetit Kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, si dhe të ndryshojë apo revokojë vendimin e KVO-së apo Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

6. Gjetje nga auditimi. Në nenin 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pikën 3, referenca ligjore nuk është e saktë. Neni 45 “Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve” LPP-së, shprehet për rastet e s’kualifikimit të operatorëve ekonomikë nga procedura e prokurimit, ndërsa përse ju përket kriterëve kualifikuese, ato janë të përcaktuara në nenin 46 të LPP-së.

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Të bëhet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 46 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

7. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi është evidentuar se referimi në çmimet e tregut, si një nga mënyrat e përcaktimit të vlerës limit të kontratës, nuk është i përcaktuar qartë në nenin 59, pika 2. Në VKM, duhet të shprehet qartë nëse merret për bazë oferta më vlerën më të ulët, apo vlera mesatare e ofertave të paraqitura. Meqenëse përdorimi i mesatares neutralizon edhe ekstremitetet (+/-), si dhe për faktin që vlera limit e kontratës përbën nivelin më të lartë të lejuar, gjykojmë se përdorimi i mesatares së ofertave të paraqitura është më i drejtë.

Gjithashtu, për të arritur në një vlerë limit të kontratës, sa më reale gjykojmë se është e nevojshme që autoritet kontraktore të mbështeten në dy ose më shumë alternativa në përlllogaritjen e saj.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2 të ndryshohet:

Është: Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Të bëhet: Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet dy ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut, përlllogaritur si mesatare e ofertave të paraqitura; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

c) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

8. Gjetje nga auditimi. Referuar rregullave të prokurimit publik, neni 57 “Njësia e prokurimit” njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, prandaj për këtë arsye “Njoftimi i kontratës” si një dokument i prokurimit i hartuar nga njësia e prokurimit, pavarësisht se nënshkruhet nga Titullari i autoritetit kontraktor, duhet të nënshkruhet edhe nga njësia e prokurimit.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” pika 3.

Është: Pas hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia dhe nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, njësia e prokurimit i dërgon ato për publikim në përputhje me nenet 38 e 39 të LPP.

Të bëhet: Pas hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia dhe nënshkrimit të njoftimit të kontratës prej saj dhe nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, njësia e prokurimit i dërgon ato për publikim në përputhje me nenet 38 e 39 të LPP.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar se, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, në nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës” pikat 5 dhe 6 është përcaktuar:

“5. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me

shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.

6. *Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.*

Në këtë pikë të nenit nuk janë përcaktuar qartë dy momente:

Së pari, nuk është përcaktuar se sa është ndryshimi i dukshëm (+/-) në përqindje kundrejt çmimit të kontratës.

Së dyti, nuk është përcaktuar qartë se cili është momenti kundrejt të cilit duhet të krahasohet çmimi i kontratës për të përlogaritur këtë diferencë. Çmimi i kontratës kundrejt çmimit sipas Reuters në momentin e shitjes (faturimit të mallit), apo çmimi i kontratës kundrejt çmimit sipas Reuters në momentin e zhdoganimit të mallit sipas SAD (Dokument i vetëm administrative).

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës” pika 5 dhe 6 të ndryshohen:

Është:

Pika 5 “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

Pika 6 “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

Të bëhet:

Pika 5 “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, *ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.*

Pika 6 “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në momentin e shitjes së mallit objekt kontrate autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”

10. Gjetje nga Auditimi. Nga auditimi është evidentuar fakti se përcaktimi në nenin 15 të VKM-së “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, pjesa ku shprehet për kandidatët apo ofertuesit e huaj, krijon pabarazi dhe diskriminim ndaj operatorëve ekonomikë vendas. Në nenin 15 përcaktohet: “...Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, një vetë deklaratë me shkrim”, ç’ka vjen në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi” germa d, e LPP-së, ku përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të ndryshohet:

Është: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 45 të LPP. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, një vetë deklaratë me shkrim.

Të bëhet: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 45 të LPP. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojnë dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, dokumente të ngjashme që vërtetojnë plotësimin e kritereve të kërkuara të shoqëruara me një vetë deklaratë me shkrim.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar se në nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, paragrafi I, nuk del qartë fakti se cili është kufiri i lejueshëm i gabimeve materiale, për të cilat autoritetet kontraktore e pranojnë një ofertë si të vlefshme.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, paragrafi I, të ndryshojë:

Është: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Të bëhet: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta se plus/minus 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar se në nenin 18 “Sigurimi i ofertës”, në pikën 1, janë përjashtuar nga kërkesa për paraqitjen e sigurimit të ofertës, procedurat e prokurimit me vlera nën kufirin e lartë monetare, gjë e cila nën gjykimin e KLSH-së, ndikon në tërheqjen e ofertuesve pas klasifikimit të ofertave, duke favorizuar ofertues të caktuar e duke çuar deri në dështimin e procedurave.

Sa më sipër rekomandojmë:

Në nenin 18 “Sigurimi i ofertës”, të reflektohen ndryshimet:

Ishte: Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni. Në këtë rast, sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

Bëhet: Në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor duhet t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni. Në këtë rast, sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

c. Ndryshime mbi udhëzimet e nxjerra nga APP, në zbatim të rregullave të prokurimit publik.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar që në udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” pika 1, por edhe në ndonjë akt tjetër nënligjor të prokurimeve publike, nuk është përcaktuar se si do të vepronë autoritet kontraktore në rastet e tjera të pritje përcjelljeve të delegacioneve të huaja të cilat nuk janë përfshirë në “protokollin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”.

Sa më sipër rekomandojmë:

a. Udhëzimi nr. 1, datë 21.01.2016, pika 1:

Është: Në fund të pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, kjo procedurë prokurimi përdoret edhe për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, ku vlera e përlllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup-artikujsh brenda një viti kalendarik, është nën vlerën e kufirit të ulët monetar”.

Të bëhet: Në fund të pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Përjashtimisht, kjo procedurë prokurimi përdoret për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për pritje përcjellje dhe trajtimin që ju bëhet delegacioneve të huaja”, ku vlera e përlllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup-artikujsh brenda një viti kalendarik, është nën vlerën e kufirit të ulët monetar”. Autoritetet kontraktore do të mbajnë procesverbalin sipas formularit 5/1, bashkëngjitur udhëzimit.

b. Udhëzimi nr. 1, datë 21.01.2016, Shtojca/Formulari nr. 5/1

Është: “Procesverbal për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së ceremonialit zyrtar”

Të bëhet: “Procesverbal për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së pritje përcjelljeve të delegacioneve të huaja”.

14. Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, nga organi qendror blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë" është evidentuar:

a. Në nenin 1 të udhëzimit, pika 1, germa (ë), nuk është përshkruar në përputhje me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”.

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: “Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike:

Të bëhet: “Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike, përveç filtrave të automjeteve”.

b. Në nenin 2 të udhëzimit, nuk është përcaktuar afati i paraqitjes së kërkesave nga autoritetet kontraktore, sipas përcaktimit të bërë në VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime” pika 3).

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: “Autoritetet kontraktore dërgojnë pranë Organit Qendror Blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, me anë të një kërkesë të veçantë të bërë në formë shkresore dhe elektronike, nevojat

për mallrat dhe shërbimet e sipërpërmendura, ku përcaktohen specifikimet teknike, sasitë e mallrave ose shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe vlerën e përlogaritur (pa TVSH).”

Të bëhet: “Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, specifikimet teknike, sasitë e mallrave ose shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe vlerën e përlogaritur (pa TVSH)”.

15. Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik” pika 3, paragrafi I, nuk është trajtuar saktë, pasi nëse nuk është organ varësie do të thotë që është organ qendror dhe afati i përcaktuar për dërgimin e regjistrit të parashikimeve në APP, për organet qendrore është data 31 Janar, e cila është përcaktuar në pikën 2 të udhëzimit.

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: “Nëse autoriteti kontraktor nuk është organ varësie, regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i hartuar dhe i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor do të dërgohet për publikim në APP brenda datës 15 janar të çdo viti”.

Të bëhet: “Nëse autoriteti kontraktor është organ qendror, por nuk ka organe në varësi, regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i hartuar dhe i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor do të dërgohet për publikim në APP brenda datës 15 janar të çdo viti”.

16. Gjetje nga auditimi: Në udhëzimin nr. 6, datë 27.01.2015 “Për Përdorimin e marrëveshjes kuadër”, nuk janë përcaktuar saktë referencat ligjore mbi të cilat ka dalë ky udhëzim.

Sa më sipër rekomandojmë:

Është: Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 83, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të bëhet: Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 83, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, *Kreu V, nenet 41,42,43,44,45,46,47.*

C. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në programimin për transparencën për Agjencinë e Prokurimit Publik është konstatuar mungesa e publikimit të vendimmarrjes së institucionit, mbi shqyrtimin e rekomandimeve të organeve audituese për procedurat e prokurimit, mbi procedurat e hetimit administrativ dhe mbi shqyrtimin e kërkesave për përjashtim të operatorëve ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik për 1-3 vjet. APP nuk publikon në faqen e internetit arsyetimet dhe vendimet, si dhe dhënien e masave administrative apo propozimet për titullarët e AK-ve për masa disiplinore, si dhe vendimet për përjashtimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Sa më sipër trajtuar në faqen 44-45 të RPA, rekomandojmë:

Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa që në programet e transparencës të bëhen plotësime duke përfshirë në të publikimin e plotë të vendimeve të APP-së, për masat administrative e disiplinore ndaj personave përgjegjës, të argumenteve që paraqiten lidhur me përjashtimin e operatorëve ekonomikë përkohësisht nga procedurat e prokurimit. Kjo i shërben transparencës,

duke zgjeruar lirinë e aksesit në dokumentacionin administrativ dhe lirisë së informacionit, garancisë së një drejtësie administrative dhe motivimin e vendimeve të marra.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se midis APP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, pavarësisht korrespondencës nuk ka patur rezultate në minimizimin e rasteve, kur operatorë ekonomikë, për plotësimin e kriterëve të cilësisë paraqesin certifikata të lëshuara nga trupa të pa akredituara nga institucione të specializuara kombëtare ose ndërkombëtare. Nga ana tjetër, për shkak të kërkesës së lartë nga subjektet që kërkojnë të marrin pjesë në tender, trupat certifikuese jo vetëm që ofrojnë shërbime të pa akredituara, por në shumë raste nuk ndjekin procedurat korrekte të certifikimit. Në këto kushte, kriteri i certifikimit të subjekteve si garanci për shërbimin që ofrohet zhvlerësohet dhe cilësia e shërbimit nuk është ajo e përcaktuar në standardin, të cilit i është referuar AK.

Sa më sipër trajtuar në faqet 46-47 të RPA, rekomandojmë:

Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, duke e vënë në dijeni të të gjitha rasteve të identifikuara, kur autoritete të pa akredituara nga institucione të specializuara kombëtare dhe ndërkombëtare, pajisin me certifikata të cilësisë operatorë ekonomikë, si dhe ti bëjnë ato publike, në faqen e www.app.gov.al.

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i raporteve të auditit për procedurat e prokurimit, konstatohet se APP nuk ka vepruar me kompetencën e duhur, për të parandaluar dhe ndëshkuar vlerësimet me dy standarde nga KVO, në procesin e kualifikimit të operatorëve pjesëmarrës në konkurrim. Vlerësimi me dy standarde nga KVO, është konstatuar në procedura të ndryshme por dhe brenda një prokurimi. Ndërsa qëndrimi dhe vendimi i APP-së ndaj këtij fenomeni ka qenë: *“Në mbështetje të neneve 13, pika 2/i të LPP, t'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore, si persona përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me nenin 53 të LPP, në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës dhe sipas konstatimeve në këtë vendim”*.

Shpesh në materialet e dosjeve të audituara, konstatohet se, masa administrative “gjobë” e rekomanduar nga organi auditues, nuk është zbatuar nga APP, duke i rekomanduar titullarit masë disiplinore, këshillim apo edhe tërheqje vëmendje, për mos përsëritjen e veprimeve, në kundërshtim me bazën ligjore e rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, me vendimin nr. 4, datë 7.01.2016, lidhur me shqyrtimin e Raportit Përfundimtar të KLSH (pjesa e prokurimeve publike), në **autoritetin kontraktor ish Ministria e Arsimit dhe Sportit** (sot Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), APP ka analizuar shkeljet në dy procedura prokurimi dhe pasi ka vlerësuar të drejta shumicën e konstatimeve të KLSH-së, për masat është shprehur: APP i tërheq vëmendjen grupit të punës për shqyrtimin e projektit e përllogaritjen e fondit limit dhe anëtarëve të KVO, për parregullsitë e vërejtura, sipas konstatimeve në këtë vendim, që të jenë të kujdesshëm në të ardhmen gjatë fazës së përllogaritjes së fondit limit dhe vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër trajtuar në faqet 49-51 të RPA, rekomandojmë:

Agjencia e Prokurimit Publik të marrë masa, që për shkelje të natyrës përcaktuese për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit, në zbatimin rigoroz të kriterëve kualifikuese të paracaktuara, apo edhe në zbatimin e afateve të ankimit nga operatorët ekonomikë, si dhe shqyrtimin profesional e me paanshmëri të tyre, minimalisht ndaj personave përgjegjës, të aplikojë vendosjen e masa administrative referuar nenit 72 të LPP-së, me qëllimin dekurajimin dhe minimizimin e veprimeve joligjore të zyrtarëve të prokurimit. Në rastet e shkeljeve flagrante

të ligjit e akteve nënligjore të prokurimit, APP të ushtrojë të drejtën për t'u drejtuar organeve të prokurorisë e gjykatës.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se APP për dhënien e masave administrative apo propozimeve për masa disiplinore, në përfundim të shqyrtimit të hetimeve administrative, shqyrtimit të raporteve audituese, apo kërkesave për përjashtim të operatorëve ekonomikë përkohësisht nga procedurat e prokurimit publik, ka vepruar me standarde të ndryshme, nuk ka një referencë dhe koherencë në vendimet e marra. Ky konfuzion vjen për shkak se APP nuk ka të përcaktuar asnjë standard, procedurë, kriter vlerësimi, element ku mbështetet për përcaktimin e shkallës së shkeljeve të AK, si dhe raportit të tyre me masat administrative apo disiplinore. Në dispozitivin e vendimeve të mësipërme nuk ka asnjë rresht mbi konkluzionet e dala nga hetimi administrativ, si dhe ku mbështeten në dhënien e masave.

Sa më sipër trajtuar në faqen 29-44 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i APP-së të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e rregullores së procedurave/manual/udhëzime mbi të cilin duhet të mbështeten specialistët e APP-së gjatë kryerjes së hetimit administrativ (monitorimit), ku të përcaktohet:

- Shkalla hierarkike e zhvillimit të procedurës që nga nxjerrja urdhrit deri tek vendimi, personat që do të përfshihen në monitorimin e një praktike si dhe përgjegjësitë e tyre referuar trajtimit të çështjes dhe vendimmarrjes;
- Të përcaktohet shkalla e masës administrative (në %) në raport me vlerën limit të kontratës, duke u mbështetur edhe në aktet tjera ligjore që rregullojnë këtë procedurë;
- Të përcaktohet shkalla e shkeljeve sipas rëndësisë së tyre, cilat do të konsiderohen shkelje që sjellin pasoja dhe cilat janë shkelje që nuk sjellin pasoja;
- Të përcaktohet formati dhe rubrikat apo kapitujt që duhet të përmbajë vendimi i monitorimit;
- Të përcaktohet paraprakisht hartimi i një projektvendimi, ku të paraqiten propozimet e specialistëve mbi masat ndaj AK, i cili me miratim me/ose pa vërejtje nga ana e titullarit të kalohet në vendim.
- Të parashikohet mënyra e trajtimit të rasteve kur mangësitë e konstatuara nuk përbëjnë rast për dhënie mase. Rekomandojmë që për këto raste të dilet me konkluzione dhe rekomandime, të cilat nëse janë përgjithësuese të publikohen në faqen e APP-së dhe t'ju shërbejnë të gjithë AK.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se APP, ka të miratuar Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ku në nenin 6 “Detyrimi për vetë deklaram ose deklarimi me kërkesë të eprorit” është cilësuar: *“Parandalimi i llojeve të veçanta të konfliktit rast për rast të interesit do të realizohet si vijon: a-Çdo zyrtar në ushtrimin e kompetencave apo kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetë deklaram paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave të tij privatë që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi”*. Përsa më sipër, për shkak se punonjësit e APP janë pjesë e shqyrtimit dhe vendimmarrjes mbi praktikat e prokurimit publik pas lidhjes së kontratës, shqyrtimit të kërkesave dhe vendimmarrjeve për përjashtimin e OE deri në tre vjet nga procedurat e prokurimit, si edhe të shqyrtimit të raporteve të auditimit për vlerësim të shkeljeve dhe vendimmarrjes për dhënien e masave ndaj personave përgjegjës në raport me to, duhej që për çdo rast të plotësonin paraprakisht deklaratën e konfliktit të interesit.

Sa më sipër trajtuar në faqen 29-44 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik, duhet të përcaktojë në Rregulloren e Brendshme të Organizimit të Punës në Agjencinë e Prokurimit Publik, Rregulloren “Për parandalimin e

konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” detyrimin për plotësimin e “Deklaratës mbi konfliktin e interesit” për çdo rast përpara shqyrtimit të procedurave dhe vendimmarrjes nga stafi i APP-së, si dhe të miratojë formën e deklarimit, ku të deklarohet se:

a. Nëpunësi i APP në momentin e nënshkrimit të deklaratës mbi konfliktin e interesit, nuk është në dijeni të ekzistencës së konfliktit të interesave (në fakt/apo në dukje) ose faktorë të tjerë, që kufizojnë në kryerjen e detyrave të caktuara me objektivitet, vërtetësi dhe korrektësi, në respekt të zbatimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Mbi prokurimin publik” me ndryshime dhe akteve nënligjore të fushës së prokurimit publik, si dhe me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Organizimit të Punës së APP-së, si dhe akteve të tjera rregullatore.

b. Në rast të shfaqjes së ndonjë konflikti të mundshëm interesi, apo çështje të tjera të kësaj natyre gjatë kryerjes së veprimtarisë, do të njoftojë menjëherë drejtuesit sipas përcaktimeve të legjisllacionit përkatës.

6. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit ka rezultuar se nëpunësi zbatues (NZ) i Agjencisë së Prokurimit Publik, është me profesion “Jurist”, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” pika 1 ku përcaktohet: *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike”.*

Sa më sipër trajtuar në faqen 12-19 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA), të marrë menjëherë masat për zëvendësimin e Nëpunësit Zbatues aktual me profesion jurist me një nëpunës me profesion ekonomist.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përlllogaritjeve të amortizimit të pajisjeve IT, ka rezultuar se ndodhen në magazinë pajisje jashtë funksioni për të cilat paraqitja e tyre në kontabilitet nuk është bërë me vlerën të mbetur, duke përlllogaritur amortizimin vjetor, deri në përfundimin e procedurave sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime. Për rrjedhojë në pasqyrën nr. 1 të aktivitetit të bilancit, këto materiale janë paraqitur me vlerën fillestare e mbetur të vitit 2013 në shumën 2,693,700 lekë dhe jo me vlerën e mbetur të vitit 2015 dhe 2016, pas zbritjes së amortizimit, në kundërshtim me Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 me ndryshime “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësiteve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007, Kapitulli III “Shpjegime lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e pasqyrave financiare të vitit 2006” pika 1 “Për Aktivin e Bilancit kontabël”.

Gjithashtu, nga Titullari i APP-së nuk janë ngritur komisionet e vlerësimit, nxjerrjes jashtë përdorimit, apo asgjësimit të tyre, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

Sa më sipër trajtuar në faqen 12-19 të RPA, rekomandojmë:

7.1. Nëpunësi zbatues, si personi përgjegjës për: *“Mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave. Sistemi i kompjuterizuar i thesarit mund të përdoret për kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve financiare të njësisë publike, bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria e Financave”*, të marrë masa për përlllogaritjen e amortizimit për mallrat në vlerën 2,693,700 lekë, të kryejë sistemimin kontabël dhe të pasqyrojë në bilancin e vitit 2017.

7.2. Titullari i APP-së, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e komisionit të inventarizim/vlerësimit/nxjerrjes jashtë përdorimi dhe komisionit të asgjësimit të materialeve në vlerën 2,693,700 lekë, në zbatim të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

8. Gjetje nga auditimi: Në referencë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa “b” është evidentuar se nuk është hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik, i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndër sektoriale për fushën e teknologjisë dhe informacionit. Ky institucion punon si pjesë e planeve strategjike të projekteve të ndryshme.

Sa më sipër trajtuar në faqen 19-23 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i APP-së duhet të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit për një periudhë 3 vjeçare. Gjithashtu, duhet të bëhen pjesë e objektivave strategjike edhe ato pjesë të planeve strategjike të projekteve të ndryshme, ku APP është e përfshirë.

9. Gjetje nga auditimi: Për Politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, në ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, u konstatua se nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, gjithashtu nuk ka kryer trajnime referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikën dhe praktikën që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

Sa më sipër trajtuar në faqen 19-23 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i APP-së të marrë masa për hartimin e planit vjetor të trajnimeve, përcaktimit të temave sipas nevojave të shprehura nga stafi, me qëllim përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së APP-së.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se, nuk është përcaktuar harta e proceseve dhe gjurma e auditimit, për proceset kryesore që zhvillon APP, si monitorimet, shqyrtimi i kërkesave për përjashtim të operatorëve ekonomikë, dhënia e mendimeve dhe asistencës ligjore ndaj autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë apo palëve të tjera, hartimi i projekt-propozimeve, shqyrtimi i raporteve të auditimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” pika 2 ku përcaktohet: *“Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike*

dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”, si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Sa më sipër trajtuar në faqen 19-23 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i APP-së të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit, pasi ajo përfaqëson: *rrijdhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe hartës së proceseve me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.*

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 21 raste të kthimit të përgjigjeve për dhënie asistence sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë etj, nuk është respektuar afatit 10 ditor. Kthimi i përgjigjeve në aftat ka rëndësi për ecurinë e procedurave të prokurimit publik në kohën e duhur.

Sa më sipër trajtuar në faqen 23-29 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik të marrë masa për ndërprerjen e praktikave të tilla, në vazhdim kthimi i përgjigjeve për asistencë teknike, interpretime dhe dhënie mendimi duhet të jetë brenda afateve me qëllim mos pengimin e kryerjes së procedurave të prokurimit në kohë.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Agjencia e Prokurimit Publik nuk dispononte praktika mbi projekt-propozimet për ndryshime ligjore. APP ka për detyrë të paraqesë në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, të përgatisë projekt-propozimet për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura. Me përjashtim të ndryshimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me VKM nr. 823, datë 23.11.2016, në asnjë nga praktikat e tjera nuk ka të dokumentuar hartimin e projekt propozimeve, iniciativa, argumentimi, nga ngritja e grupit të punës dhe deri te përcjellja për në Këshillin e Ministrave.

Sa më sipër trajtuar në faqen 23-29 të RPA, rekomandojmë:

Titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik, duhet të marrë masa për krijimin e praktikave ligjore, të dokumentojë hartimin e projekt-propozimeve për prokurimin publik duke filluar që nga ngritja e grupit të punës, iniciativën ligjore dhe deri tek përcjellja e tyre për në Këshillin e Ministrave.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kriteret e përzgjedhjes për monitorimin e procedurave të prokurimit, ankandeve, dhe koncesioneve (PPP), u konstatua se nga APP, nuk është mbuluar në masën e duhur monitorimi i procedurave sipas fushës dhe llojit të tyre, ç’ka ndikon në mos identifikimin e shkeljeve, mangësive si dhe marrjen e masave ndaj AK, por më së shumti për të evidentuar mangësitë e legjislacionit, procedurave, dokumenteve dhe marrjen e masave dhe përmirësimeve të tyre për të ardhmen. Kështu u konstatua se:

- është realizuar një numër të konsiderueshëm procedurash “*Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”, të cilat në raport me procedurën “tender i hapur” në vitin 2015 rezultojnë të jenë 1.8 herë më shumë, në vitin 1.2 herë më shumë dhe në janar-gusht 2017 rezultojnë 1.5 herë më shumë, për të cilat duhej të kryhej në raport proporcional një numër më i lartë monitorimesh.

- APP gjatë periudhës objekt auditimi, nuk ka kryer asnjë hetim administrativ (monitorim), për “Marrëveshjet kuadër” “Koncesionet/PPP” dhe “Ankandet publike”.

Sa më sipër në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” me ndryshime, neni 11, dhe Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” me ndryshime, neni 7, si dhe me Rregulloren nr. 1, datë 01.02.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e APP-së”, neni 9.

Sa më sipër trajtuar në faqen 29-44 të RPA, rekomandojmë:

Nga titullari i APP-së të merren masa për një organizim më të mirë dhe më gjithëpërfshirës të planit të monitorimeve, me qëllim mbulimin e të gjitha llojit të procedurave në proporcion me numrin, rëndësinë, fondet, riskun që paraqesin të fushës së prokurimeve, veçanërisht në procedurat “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, koncesioneve dhe ankandëve publike.

KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200) e veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti-Agjencia e Prokurimit Publik, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

1. APP ka vepruar në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik gjatë monitorimit nga ana e saj të procedurave të prokurimit pas lidhjes së kontratës nga autoritetet kontraktore, shqyrtimit të raporteve të auditimit të strukturave audituese etj., por nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e paracaktuara përsa i përket vendimmarrjes referuar shkeljeve të kryera nga autoritet kontraktore. Në lidhje me këtë çështje ka raste të qëndrimeve të ndryshme, për shkelje të njëjta, duke “abuzuar” me të drejtën diskrecionale që ligji i njeh APP-së.

Mungon gjurma e auditimit, nuk ka procedura apo kriteret të miratuara mbi këto procese kryesore të veprimtarisë së saj, gjë që ka shkaktuar marrjen e vendimeve subjektive në dhënien e vendimeve ndaj zyrtarëve të prokurimeve publike, të shoqëruara me uljen e ndikimit dhe efektivitetit të punës tek operatorët ekonomik, për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

2. Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm, por në disa komponentë të tij si evidentimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre si dhe përcaktimi i gjurmës së auditimit, ka vend për përmirësim.

3. APP ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fazën e planifikimit, zbatimit dhe raportimit të buxheteve vjetore, ka dorëzuar në afat dhe ka përgatitur në përputhje me kriteret e vlerësimit pasqyrat financiare, si dhe ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit për inventarizimin e pronës.

4. Gjatë auditimit u evidentuan disa raste të mangësive në aktet ligjore e nënligjore, për të cilat janë propozuar përmirësimet përkatëse.

Opinion i audituesve:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Agjencia e Prokurimit Publik nuk u

konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES:

Pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

- Projektraporiti i Auditimit dërguar me shkresë nr. 860/4, datë 25.11.2017;
- Akt Konstatimi nr. 1, datë 13.11.2017, “Mbi sigurimin e transparencës, bashkëpunimit me të tretët, për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik; me entet e tjera për zbatimin e standardeve kombëtare në përgatitjen e specifikimeve teknike nga autoritet kontraktore; me organet e auditimit publik, si KLSH, strukturat e Auditimit të Brendshëm, Inspektimin Financiar mbi shqyrtimin e raporteve audituese të paraqitura prej tyre”, protokolluar në APP me nr. 10950/8, datë 14.11.2017.
- Akt Konstatimi nr. 2, datë 14.11.2017 “Mbi verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës”, protokolluar në APP me nr. 10950/9, datë 14.11.2017.
- Akt Konstatimi nr. 3, datë 14.11.2017 “Mbi përjashtimet e operatorëve ekonomik nga pjesmarrja në prokurimet publike”, protokolluar në APP me nr. 10950/10, datë 14.11.2017.
- Akt Konstatimi nr. 4, datë 14.11.2017 “Mbi këshillat dhe asistencën teknike që jep APP për autoritetet kontraktore që ndërmarrin një procedurë prokurimi”. protokolluar në APP me nr. 13889, datë 14.11.2017.
- Akt Konstatimi nr. 5, datë 14.11.2017 “Mbi vlerësimin e funksionimit të Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”. protokolluar në APP me nr. 13889/1, datë 14.11.2017.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. Fadil Dekovi, Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. Brunilda Zeneli, Audituese
3. Erjola Meçaj, Audituese

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Lindita LATI